

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7311 E martë 3 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

3 tetori 1990, dita e ribashkimit të Gjermanisë që erdhi pas shembjes së Murit famëkeq të Berlinit, është një ditë e madhe reflektimesh të shumta historike lidhur...

Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

Ribashkimi dhe mençuria politike gjermane



Opinion

Ditës

Çfarë ju vjen ndërmend kur dëgjoni apo lexoni fjalën "personale"? Mua për vete, sa herë e them, e shkruaj, e lexoj apo e dëgjoj këtë fjalë, më ..

Vijon në faqen 21

Nga ARIAN GALDINI

Personelizimi si rënie e demokracisë!



Vetingu përplas gjyqtarët me politikanët

Donald Lu: Katër klane kontrollojnë Shqipërinë, Fildezi u la në baltë

Ambasadori amerikan: Ka shumë Shullazë, Lul Berisha dhe Klement Balilë të tjerë në Shqipëri

Nga VALENTINA MADANI

Ambasadori amerikan, Donald Lu lëshoi dje të tjera akuza të forta për sistemin e drejtësisë. Në 20-vjetorin e Shkollës së Magjistraturës, diplomati amerikan foli hapur se në vend ka 4 klane kriminale,...

Në faqet 2-5

DEM SHPËRBLIMI/ EMRAT E TRASHËGIMTAREVE DHE DOKUMENTET QE DUHEN PLOTËSUAR

ISH-TE PERNDJEKURIT, 350 PERFITUESIT E RINJ

Ministria e Financave: Keni vetëm dy muaj afat për të marrë këstin e dytë të demshpërblimit. Hapat që duhet të ndiqni për të mos ju kthyer pas



(Në foto) Ish-te perndjekur në protestë

Në faqen 6

FOTOT NGA PUNIMET

Ndërtim në Butrint, Berisha: Rama po e bën vilë familjare, ministria: Ka qenë

Në faqen 11

DESHMIA NE POLICI

Sulmohet ish-shefi i SHIK në Berat, dhunuesit: S'ka mbaruar me kaq

Në faqen 8

PARANDJENJA

Shuhet Robert Elsie, Shqipëria bisedime me familjen për t'i realizuar amanetin

Në faqet 12-13

ÇFARE NDODHI

Sulm terrorist në SHBA, viten 50 vetë, 200 plagosen. Kush është autori

Në faqen 15

DETAJET E REJA



Atentati në Vlorë, pranga Llanajt. Zbardhet dëshmia e plotë në polici

Në faqen 9

Hapet sërish portali 'U-Albania', regjistrimet vazhdojnë deri në 14 tetor

Universitetet, kush fiton te Politekniku e Bujqësori

Raundi i dytë, emrat në Financë-Kontabilitet, Inxhinieri Elektronike e Informatikë

Nga VOLTIZA DURO

Që prej 1 tetorit, të gjithë maturantët e shpallur fitues në raundin e dytë, kanë mundësi të regjistrohen në universitet për vitin e ri akademik 2017-2018. Ky proces do të vijojë deri më datë 14 tetor, e brenda kësaj kohe,



studentët duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës pranë sekretarive mësimore. Sot, "Gazeta Shqiptare" publikon listat me emrat e aplikantëve që rezultojnë fitues në një nga tri degët e Fakultetit të Teknologjisë dhe Informatikës të ...

Në faqet 16-19

ZBATIMI I VETINGUT REAGIMET


Presidenti pret shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Neukirch

Vetingu, Meta mbledh KLD, raporton grupi i punës për rivlerësimin

Bashkëpunim ndërinstytucional për zbatimin efektiv

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta mbledhi dje Këshillin e Lartë të Drejtësisë nga ku u njoh prej anëtarëve të KLD-së mbi takimet dhe hapat e ndërmarra nga grupi i punës, që KLD ngriti mbledhjen e kaluar, me qëllim rakhordimin dhe miratimin e akteve të përbashkëta, me institucionet e ngarkuara nga ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve. Grupi i punës informoi anëtarët e Këshillit se gjatë takimeve me institucionet përgjegjëse për zbatimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve është rënë dakord që të përcaktohen rregullat e detajuara për shortin, si dhe në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit do të procedohet për përfundimin e tyre, duke bashkëpunuar ngushtë edhe me partnerët ndërkombëtarë të reformës. Bazuar në konkluzionet e takimeve, grupi i punës informoi anëtarët e KLD-së, se është rënë dakord që të vijohet bashkëpunimi i ngushtë me institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, për të siguruar zbatimin efektiv dhe unifikues të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Në këtë kuadër, grupi i punës do bashkëpunojë edhe me prokurorinë për të siguruar, për aq sa është e mundur, krijimin e të njëjtës praktikë pune. "Bazuar në përcaktimet e rendit të ditës, Këshilli vijoi me shqyrtimin e projekt-akteve përfundimtare të vlerësimit, të përgatitura nga kryeinspektori i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.261/2, datë 14.04.2010 'Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve'", thuhet në njoftimin e KLD-së. Në përfundim të këtij shqyrtimi, si dhe pas vlerësimit të ankimeve përkatese, Këshilli miratoi aktet e vlerësimit për disa gjyqtarë. Gjithashtu, Këshilli i vendosi delegimin e disa gjyqtarëve në shqyrtimin e çështjeve të caktuara gjyqë-



Presidenti Ilir Meta dhe në Këshillin e Lartë të Drejtësisë

TAKIMI

Pas deklaratave të forta të ambasadorit amerikan, Donald Lu se 20 familje kriminale dominojnë krimin në Shqipëri me 4 klane kryesore, ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj zhvilloi një takim me ambasadorin Donald Lu si dhe ambasadorin e BE, Vlahutin. Mësohet se në fokus të takimit ishte situata e rendit në vend si dhe vetingu në Policinë e Shtetit.

Vetingu në polici, ministri letër çdo polici

Xhafaj: Të largojmë cilin ka fjetur gjumë para krimit

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, i është drejtuar me një letër çdo drejtuesi policie, ku pasi i shpreh mirënjohje dhe i inkurajon për të luftuar krimin dhe triumfuar mbi të. Sfidë e parë është sigurimi dhe garantimi i profesionalizmit brenda vetë forcave të policisë. "Do të duhet të ndajmë nga trupi i shëndetshëm i Policisë së Shtetit çdo gjymtyrë të gangrenuar, të lidhur me krimin, të vënë në shërbim të tij apo dhe që ka fjetur gjumë përpara krimit. Për këtë arsye, akti im i parë si ministër i Brendshëm, shënoi nisjen e procesit për organizimin e vetingu për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit. Pjesë e këtij shërbimi do të jenë vetëm



njerëz profesionalisht të aftë dhe me integritet të lartë moral", shkruan Xhafaj në letrën e tij. Ministri i Brendshëm garanton mbështetjen për çdo efektiv policie dhe shton: "Inkurajoj dhe mirëpres nga ju çdo mendim, sugjerim konkret, apo shqetësim ndaj kujtdo

qoftë ai, në funksion të përmirësimit të punës, rolit dhe reputacionit të Policisë së Shtetit. Ndaj, ju lutem mos ngurroni të më shkruani në adresën: shkruajministrit@punete-brendshme.gov.al, e cila do të jetë në dispozicionin tuaj dhe vëmendjen time. Çdokush që ka një ide, do të dëgjohej me vëmendje maksimale". Xhafaj e mbyll letrën duke shkruar: "Ne nuk kemi asnjë mundësi tjetër veçse të triumfojmë mbi këto sfida në emër të së nesërme më të mirë të prindërve dhe fëmijëve tanë. Mbi supet tona qëndron e ardhmja europiane. Sukses! Do të jetë i të gjithëve dhe për të gjithë!"

sore, në gjykata të tjera nga ku ata janë emëruar për të ushtruar funksionin e gjyqtarit. Po dje Presidenti i Republikës, Ilir Meta, priti shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Claus Neukirch. Presidenti Meta vlerësoi kontributin e dhënë nga Këshilli i Evropës për promovimin e demokracisë

dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri, vëmendjen ndaj të drejtës së pronës dhe lirisë së mediave, dhe duke u ndalur në mënyrë të veçantë në reformën në drejtësi, vlerësoi asistencën ligjore e shumë profesionale të ofruar nga Komisioni i Venecias. Një theks të veçantë presidenti Meta e vuri gjithashtu në

nevojën e bashkëpunimit mes institucioneve shqiptare dhe Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë për parandalimin dhe dekurajimin e dhunës në familje edhe ndaj grave, si dhe hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta për një trajtim sa më të gjerë të kësaj problematike të rëndësishme sociale.



Gjatë një seance parlamentare

Vasili i kujton Lu: Edhe kryebanditi ka emër

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, deklaroi dje se partia e tij ndan të njëjtin shqetësim me ambasadorin amerikan për kriminalitetin në vend. Pas mbledhjes së grupit, ai apeloj ambasadorit Lu dhe Vlahutin të ushtrojnë të gjithë ndikimin e tyre mbi mazhorancën për të kthyer mbrapsht dhe rishikuar vendimet e fundit mbi vetingun. Sipas tij, vetëm duke pasur një veting të pavarur do të mund të çlirohet drejtësia nga kapja. "Gjithçka është investuar ka qenë për një veting të pavarur. Është akoma në kohë të kthehen mbrapsht dhe të rishikohen këto vendime të turpshme, skandaloze. Nuk ka më kohë as për të heshtur dhe as për të qëndruar pasivë. Në rast se nuk ndodh, ne Shqipëri do ta linim në duar të këtyre bandave, që sot ambasadori amerikan pati meritën e madhe që t'i nominonte me gisht. U kujdes të mos nominonte vetëm kryebanditin, që ka emër dhe është ai që nuk lufton bandat, që inkurajon policinë që të mos merret me punën e saj, por të mbledhë votat", tha z. Vasili.

Paloka: Fundi i 'Noriegës' së Ballkanit

Nënkryetari i Kuvendit, Edi Paloka reagoi dje pas deklaratave të sotme të ambasadorit amerikan, Donald Lu. Paloka u shpreh se ambasadori u tregoi shqiptarëve se vendi është nën sundimin e 4 klaneve, por jehona në media e këtyre deklaratave do të zëvendësohet nga shfaqja e radhës. Por sipas tij, fshehja nuk e ndryshon realitetin dhe se të gjithë e dinë si përfundoi Noriega dhe i fillë do jetë edhe fundi i 'Noriegës' së Ballkanit. "Sot i tregoi se Shqipëria, vendi ynë, është nën sundimin e katër klaneve dhe 20 familjeve kriminale. Askush nuk u mallëngye nga këto të vërteta dhe me siguri në media jehona e këtyre deklaratave do të shuhet shpejt, për t'i lënë vend shfaqjes së radhës. Por, kjo do të thotë të fusësh kokën në rrëzë si struci, se fshehja në media nuk e ndryshon realitetin që shqiptarët e përjetojnë çdo ditë. Kjo nuk ndryshon as fundin e historisë, të gjithë e dinë si e filloi dhe si përfundoi Noriega. I njëjtë do jetë fundi dhe për 'Noriegën' e Ballkanit", shkruan Paloka.



"Shullazi trafik droge nga burgu, Berisha i lirë nga paaftësia e institucioneve"

Donald Lu, i ashpër me drejtësinë: 4 klane kontrollojnë Shqipërinë

"Fildezen, sistemi gjyqësor e la në baltë"

Valentina Madani

Ambasadori amerikan, Donald Lu lëshoi dje të tjera akuza të forta për sistemin e drejtësisë. Në 20-vjetorin e shkollës së magistraturës, diplomati amerikan foli hapur se në vend ka 4 klane kriminale, në përbërje të të cilave janë 20 familje. Donald Lu gjatë fjalës së tij citoi raporte të Departamentit të Shtetit, sipas të cilave Shqipëria është qendër e aktivitetit të krimit të organizuar, që përfshin trafikun e drogës, armëve dhe prostitucionit. "Katër klane kryesore kontrollojnë 20 familje kriminale, ku përfshihen trafikun njerëzor, shantazhi, vjedhja e makinave dhe pastrimi i parave", deklaroi ambasadori Lu.



Ambasadori amerikan, Donald Lu

AKUZA

"Katër klane kryesore kontrollojnë 20 familje kriminale, që menaxhojnë operacione kriminale, ku përfshihen trafikun njerëzor, shantazhi, vjedhja e makinave dhe pastrimi i parave", deklaroi ambasadori Lu.

KANABISI

"Sfida më e madhe është ende përpara. Derisa peshqit e mëdhenj të arrestohen, të ndiqen penalisht dhe të futen në burg, kanabisi do të kthehet, gjyqtarët do të marrin rryshfet dhe zyrtarët qeveritarë do të korruptohen", - u shpreh ambasadori Lu.

Kërkesa e OSBE-së, Wilton: Reforma në drejtësi, e prekshme dhe e besueshme

Robert Wilton, zëvendëskryetari i Prezencës së ROSBE-së në Shqipëri, deklaroi dje se "Zbatimi i reformës në drejtësi do të thotë që duhet të përmirësohen procedurat, praktikat dhe qëndrimet në çdo sektor të sistemit të drejtësisë". Gjatë fjalës së tij me rastin e 20-vjetorit të Shkollës së Magistraturës, Wilton përmendi se "Reforma e vërtetë nuk bëhet me letra apo në parlament; reforma e vërtetë bëhet në çdo sallë gjyqi dhe zyrë juridike në vend". Sipas tij, "Reforma në drejtësi duhet të jetë e prekshme dhe e besueshme për qytetarët e Shqipërisë. S'ka për të pasur reformë për sa kohë që qytetarët nuk besojnë te drejtësia e sistemit kur hyjnë në sallën e gjyqit". Wilton tha se OSBE-ja e mbështet reformën e drejtësisë në Shqipëri, bashkë me kolegët e organizatave ndërkombëtare që kanë luajtur një rol kaq të rëndësishëm në këtë proces.



Ministrja: Disa magistratë, lidhje me elementët kriminalë

Javën e ardhshme nis vetingu, ndërkohë që ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, deklaroi se nevojitet përmirësim në rekrutimin e kandidatëve për institucionet e reja të drejtësisë. Madje ajo bëri edhe një deklaratë të fortë, duke u shprehur se disa magistratë kanë pasur lidhje me elementët kriminalë. Deklarata u bë në 20-vjetorin e magistratëve, nga ku ambasadorët Lu dhe Vlahutin shprehën mbështetjen për çuarjen përpara të vetingut. Nga ana e tij, kreu i Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori apeloi magistratët të kandidojnë për t'u bërë pjesë e sistemit të ri të drejtësisë. "Nëse jeni të pastër, rrii të qetë. Mos hezitoni të kandidoni. E ardhmja e drejtësisë jeni ju. Pjesa më e shëndoshë do të zgjidhen në institucionet e drejtësisë. Mos hezitoni të kandidoni", - theksoi z. Zaganjori.



20-vjetori i Magistraturës, diskutohet vetingu

Vlahutin: BE do të mbështesë SPAK për goditjen e korrupsionit

Ambasadorja e delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë, Romana Vlahutin, shprehu dje mbështetjen e BE-së për reformën në drejtësi. Duke folur në 20-vjetorin e magistraturës, Vlahutin tha se do të bëjnë çmos që institucionet e reja të drejtësisë dhe SPAK të luftojnë paligshmërinë dhe korrupsionin. "Kjo nuk ka qenë një punë e lehtë. Shqipëria është në prag të një sistemi të ri gjyqësor. Në muajt në vazhdim do të bëhet vetingu, i rëndësishëm për shqiptarët jashtë dhe brenda vendit. Institucio-



Ambasadorja e delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë, Romana Vlahutin

net e reja dhe SPAK-u do të duhet të gjurmohen shumë kundërligjshmëri, dhe më duhet të duhet të them se në BE do të bëjmë çmos në përkrahjen e tyre, për të bërë

toi ta mbante të shoqin e saj të rrezikshëm në burg. Dësh-toi ta mbronte kur ai u lirua. Fildezi, si të tjera gra në Shqipëri që janë viktimat e dhunës në familje, meritojnë diçka më të mirë nga sistemi i drejtësisë", - u shpreh z. Lu. Por ambasadori Lu gjen vend edhe për optimizim në pritisë të frytëve të para të dekriminalizimit, luftës ndaj kanabisit dhe vetingut, për të cilat bëri të ditur se është bërë përparim. "Vetingu i

gjyqtarëve dhe prokurorëve do të fillojë javën e vjen. Shqiptarët duhet të jenë krenarë që kanë larguar kriminelët nga parlamenti. Në këtë drejtim, Kuvendi i 2017-ës është më i mirë se Kuvendi i 2013-ës. Më në fund, shqiptarët, në qeveri dhe në opozitë, duhet të jenë krenarë për përparimin domethënës kundër kultivimit të kanabisit. Por sfida më e madhe dhe më e vështirë është ende përpara Shqipërisë - lufta kundër krim-

it të organizuar. Derisa peshqit e mëdhenj të arrestohen, të ndiqen penalisht dhe të futen në burg, kanabisi do të kthehet, gjyqtarët do të marrin rryshfet dhe zyrtarët qeveritarë do të korruptohen", - u shpreh z. Donald Lu. Diplomati amerikan kërkoi angazhim më të fortë kundër krerëve të grupeve kriminale. Sipas tij, në 2016-ën u arrestuan 1.349 persona për trafik droge, por nuk u dënua asnjë organizator, njëlloji si në 2015-ën.

STRATEGJIA OPOZITA

Kreu i PD-së: Vendi në prag greminë, qeverisin bandat dhe klanet mafioze

Basha, thirrje për front opozitar kundër "kartelit politiko-kriminal"

"Plan ligjor për mposhtjen e krimit"

Valentina Madani

Partia Demokratike do të nisë një aksion politik i cili do të përqendrohet në denoncimin e krimit, dhe për këtë në selinë blu po hartohet një projekt politik dhe ligjor. Kreu demokrat, Lulzim Basha bëri thirrje dje për krijimin e një fronti opozitar kundër kartelit politiko-kriminal, që sipas tij e ka çuar vendin në prag të greminës. Z. Basha, në përfundim të mbledhjes së Grupit Parlamentar të PD-së hodhi akuza të rënda ndaj qeverisë, kur tha se vendin e qeverisin bandat dhe klanet mafioze. "Vendi është në prag të një greminë, është një katastrofë totale sa u përket shtetit ligjor dhe demokracisë, dhe është në prag të një greminë të paimagjinueshme këto 27 vite", - deklaroi z. Basha. Sipas tij, "ky vend nuk qeveriset, sundohet nga bandat dhe klanet mafioze. Edhe nga raporti i OSBE-së u faktua që vota e 25 qershorit u ble, u dhunua dhe u tjetërsua. Fakti i dytë është që këtë e bëri Edi Rama dhe PS-ja. Fakti i tretë është se blerja dhe tjetërsimi i votës u bë me ndihmën e bandave dhe klanëve kriminale". Në mbledhjen me deputetët, ai konfirmoi se ishte diskutuar raporti i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet, çështja e ngritjes së Komisionit të Reformës Zgjedhore dhe konfirmimi i së vërtetës së njohur botërisht nga shqiptarët, se sot Shqipëria nuk qeveriset, por sundohet nga bandat dhe nga klanet mafioze.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

Komisioni



VETINGU

Ende nuk janë përcaktuar emrat e deputetëve që do përfaqësojnë Partinë Demokratike në Komisionin e Reformës Zgjedhore, por mësohet se anëtarë do të jenë edhe 4 aleatët, të cilët u zgjedhën deputetë në listën shumemerores të kësaj force politike.

kreu i PD-së. Në një situatë të tillë, z. Basha apeloj për bashkim kundër krimit të organizuar në vend. "Ndaj detyra jonë është të bëhemi së bashku në një front të gjerë opozitar dhe në një aleancë të vlerave me të gjithë qytetarët shqiptarë, e ardhmja e të cilëve, e ardhmja e fëmijëve të të cilëve cenohet rëndë nga krimi i organizuar me pushtet. Dhe t'i japim vendit zgjidhjen e vetme të kësaj gjendjeje, që është largimi i kartelit politiko-kriminal me në krye kryeministrin e votave të blera, të mazhorancës fiktive dhe të parlamentit ilëgjitim", - theksoi kreu i PD-së. Në mbledhjen e Grupit

parlamentar të Partisë Demokratike është diskutuar raporti i OSBE-së për zgjedhjet, dhe kërkesa për ngritjen e Komisionit parlamentar për Reformën në Drejtësi, që pritet të miratohet në seancën parlamentare të së enjtes. Ende nuk janë përcaktuar emrat e deputetëve që do përfaqësojnë Partinë Demokratike në Komisionin e Reformës Zgjedhore, por mësohet se anëtarë do të jenë edhe 4 aleatët të cilët u zgjedhën deputetë në listën shumemerores të kësaj force politike. "Qytetarët e kanë fare të qartë se kur një qeveri del nga shitblerja e votës, kur një qeveri vjen në

RAPORTI

Në mbledhjen me deputetët, z. Basha konfirmoi se ishte diskutuar raporti i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet, çështja e ngritjes së Komisionit të Reformës Zgjedhore dhe konfirmimi i së vërtetës së njohur botërisht nga shqiptarët, se sot Shqipëria nuk qeveriset, por sundohet nga bandat dhe nga klanet mafioze.



Foto ilustruese

THIRRJA

"Çdo mungesë vëmendjeje nga ju, duke lejuar ndërhyrjen e qeverisë në procesin e vetingut, do të cenonte rëndë jo vetëm rezultatet e procesit, por edhe besimin e qytetarëve shqiptarë dhe të partnerëve ndërkombëtarë në organet e reja të sistemit të drejtësisë, që pritet të krijohen nga ky proces jetik për Shqipërinë dhe të ardhmen e saj europiane", - tha z. Spaho.




Spaho: Reagoni, mos lejoni ndërhyrjen e Ramës në proces

Kryetari i Grupit Parlamentar të PD-së, Edmond Spaho u ka dërguar një letër ambasadorëve të SHBA dhe BE, si dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ku u ka shprehur shqetësimin mbi mënyrën e nisjes së zbatimit të reformës në drejtësi. Në letërën e tij, Spaho e vë theksin të shkurtimit i fondeve dhe stafit të organeve të vetingut, në mënyrë, sipas tij, të njëanshme të mazhorancës. "Numri i personelit ishte vlerësuar si i domosdoshëm për funksionimin autonom dhe eficient të organeve të vetingut, prej vetë këtyre organeve në relacionet shoqërore që i kishin përcjellë Kuvendit, duke ruajtur një raport të drejtë midis stafit që do të përfshihet drejtpërdrejt në procesin e rivlerësimit, me numrin e stafit mbështetës dhe administrativ, sipas raportit të ndjekur edhe nga vetë struktura e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit", - u shpreh z. Spaho. "Ndërsa mazhoranca, - shtoi ai, - në Komisionin Parlamentar të Ligjeve, pa dakordësinë e vetë organeve të reja të vetingut, vendosi të shkurtojte me rreth 40 për qind numrin e punonjësve, duke miratuar për të tre organet gjithsej 110 punonjës". "Kjo strukturë e re, e hartuar nga mazhoranca në Komisionin e Ligjeve, edhe pse nuk gjeti dakordësinë e vetë organeve kushtetuese të vetingut, u miratua po me votat e mazhorancës në seancën plenare të datës 28 shtator 2017", - theksoi z. Spaho. "Në këto kushte, - shprehet ai, - PD-ja dëshiron të sjellë në vëmendjen e misioneve diplomatike se shumica e drejtuesve të këtyre institucioneve të pavarura, jo vetëm u shprehën kundër një ndërhyrjeje, por theksuan se me ndërhyrjet e miratuara po cenohet efikasiteti i punës së organeve të pavarura kushtetuese, të ngarkuara me detyrën e realizimit të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve".

APELI

"Detyra jonë është të bëhemi bashkë në një front të gjerë opozitar dhe një aleancë të vlerave me qytetarët shqiptarë, dhe t'i japim vendit zgjidhjen e vetme, që është largimi i kartelit kriminal me në krye kryeministrin e votave të blera, të mazhorancës fiktive dhe parlamentit ilëgjitim", - tha z. Basha.



pushtet me votat e blera, edhe vetë qeveria është e blerë. Se kur përdoren kriminelët për të blerë, për të shantazhuar, për të dhunuar, për të mbledhur votat e qytetarëve, qeveria do t'u përkasë kriminelëve dhe jo qytetarëve", - deklaroi kreu i PD-së.



Valantina Madani

Shqyrtimi i ankimit të Shoqatës dhe Unionit të Gjyqtarëve, të cilët kundërshtojnë si antikush-tetuese 23 nene të tri ligjeve, pjesë të paketës së reformës në drejtësi shkaktoi për-plasje mes gjyqtarëve dhe përfaqësuesve të politikës gjatë seancës së djeshme në Gjykatën Kushtetuese. Teksa lanë ambientet ku zhvillohet 20-vjetori i Shkollës së Magistraturës, gjyqtarë të gjykatës kushtetuese dhe pjesëtarë të unionit të gjyqtarëve dhe Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve për 3 orë e 30 minuta debatuan në Kushtetuese përballë Vasilika Hysit në lidhje me padinë për shfuqizimin e vetingut dhe ligjit për statusin e gjyqtarëve. Zonja Hysi ishte e drejtpërdrejtë në argumentet e saj, duke bërë përgjegjës sistemin e drejtësisë për mosdënimin e grupeve kriminale, nisur edhe nga deklarata e ambasadorit Lu se në Shqipëri janë katër klane dhe 20 familje mafioze që mbajnë peng vendin. Ndërsa, si përfaqësues të shoqatave të gjyqtarëve, dy gjykatësit Erjon Bani dhe Gento Memollari kërkuan rëzimin e këtyre ligjeve si të pabazuara në Kushtetutë, pasi cenojnë parimet e së drejtës. Zonja Hysi kundërshtoi duke deklaruar se tashmë procesi i vetingut ka nisur dhe nuk mund të ndalet e brenda javës së ardhshme do të jenë rezultatet e para. Gjykata Kushtetuese u tërhoq për ta shpallur vendimin brenda javës në fagen e saj të internetit. Kjo e fundit mori në shqyrtim ankimin e Shoqatës dhe Unionit të Gjyqtarëve, të cilët kundërshtojnë si antikush-tetuese 23 nene të tri ligjeve pjesë të paketës së reformës në drejtësi. Ndër më të debatuarat në seancë ishte një pikë e ligjit për vlerësimin e pastërtisë së figurës së tyre. Kryetari i Shoqatës së Gjyqtarëve, Nerjon Bani e cilësoi si antikush-tetuese penalizimin që i behet një gjyqtari, nëse një i afërm i tij mund të ketë lidhje me persona me precedent penal. "Do mbajë përgjegjësi disiplinore ose penale gjyqtari apo prokurori sepse kumati apo krushqia ka pasur biografi të keqe. Kjo nuk mund të ketë asnjë lloj lidhjeje", deklaroi z.Bani. Por, përfaqësuesja e Kuvendit, Vasilika Hysi argumentoi se në përcaktimin e pastërtisë së figurës do merren për bazë të dhëna konkrete nga një sërë institucionesh dhe nuk do hotohen vetëm për një fakt apo për një foto. "Kushtetuta në aneksion e saj ka parashikuar edhe kontaktet e papërshtatshme dhe me lidhjet me krimin e organi-

Pritet vendimi, përplasje mes gjyqtarëve dhe politikës në Kushtetuese

Vetingu, Hysi: Jeni pengesë. Gjyqtarët: Ligji na cenon

"Katër klane dhe 20 familje mbajnë peng vetingun"



DEKLARATA

Nënkryetaria e Kuvendit, Vasilika Hysi, njësoj si ambasadori Lu apeloi dje për zbatimin e ligjit të vetingut. Gjatë seancës në Kushtetuese ku po shqyrtohej ankimi i Unionit të Gjyqtarëve për ligjin e vetingut, Hysi tha se ka përpjekje për ta penguar këtë ligj. "Janë 4 klane dhe 20 familje mafioze që po mbajnë peng Shqipërinë dhe pengojnë vetingun", deklaroi zj.Hysi.

AKUZA E LSI-së

LSI publikoi fakte të reja për skandalin e radarëve në det. Nënkryetari Luan Rama akuzoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA-ve për mosfunksionimin e radarëve që vëzhgojnë hapësirën detare. Në thelb të këtij skandali sipas tij qëndron korrupsioni i gjeneralëve, duke përmendur miliona dollarë të hedhura për mirëmbajtjen e radarëve.



Të enjten miratohet ngritja e Komisionit Zgjedhor

Të enjten Kuvendi do miratojë ngritjen e Komisionit të Reformës Zgjedhore. Vendimi është marrë nga maxhoranca gjatë mbledhjes së zhvilluar me ministra dhe deputetë të PS, mëngjesin e kësaj të hëne të Kryesia e Kuvendit. Në takim kanë marrë pjesë anëtarë të kabinetit qeveritar dhe përfaqësues të kryesisë së grupit parlamentar të PS. Takimi është drejtuar nga zv.kryeministrja Senida Mesi, kryetari i grupit parlamentar, Taulant Balla si dhe kreun e Kuvendit, Gramoz Ruçi. Ky format takimi do të jetë i përjavshëm dhe do të shërbejë për koordinimin e punës së qeverisë me axhendën parlamentare. Besohet se ky format takimi zëvendëson takimet e të mërkurës Rama-Meta gjatë katër viteve të qeverisë së kaluar.

Integrimi në BE, Presidenti i Greqisë kërcënon Shqipërinë

Politika greke vazhdon të japë mesazhe kërcënuese ndaj Shqipërisë për integrimin evropian në lidhje me banesat e minoritetit grek në Himarë. Presidenti i Greqisë, Prokopis Pavlopoulos, në një intervistë për të përditshmen serbe "Politika", ka deklaruar se vëprimet e autoriteteve shqiptare, që shkelin të drejtat themelore të njeriut pengojnë rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. "Kur bëjnë akte që bien në kundërshtim me konventat europiane, të tilla si shkelja brutale e të drejtave themelore të njeriut, në veçanti ajo e pronës, minojnë perspektivën evropiane", ka thënë kreun i shtetit grek. Ky mesazh i Pavlopoulos i adresohet edhe Maqedonisë në lidhje me zgjidhjen e çështjes së emrit mes dy vendeve. Edhe ministri i Jashtëm grek më herët ka bërë deklarata të tilla për çështjen e pronës së minoritetit grek në Himarë, duke kërcënuar Shqipërinë me bllokim të hapjes së negociatave për integrimin në BE. Në intervistën e tij, Presidenti i Greqisë foli edhe për marrëdhëniet e vendit të tij me Serbinë, me Turqinë dhe për rajonin.



zuar. Nëse të gjithë e dinë, kanë një foto me Shullazin apo Lul Berishën dhe nuk mund të pretendojë që unë nuk e di që ai është person ka lidhje me botën e krim-it", tha z.Hysi. Diskutime në Kushtetuese pati edhe në lidhje me pagat. Sipas grupeve të interesit, përcaktimi i pagave nuk është i drejtë. Sipas Hysit, vendosja e pagave është bërë me nivele dhe

do të jenë edhe më të larta se presidenti. "Me këtë logjikë i bie që siç kemi vënë në G3-shin ose pagën e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, që do të jetë paga më e lartë, atëherë duhet t'u paguajmë të gjithë prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme këtë pagë? Jo. Është tjetër Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë dhe është tjetër organi i Prokurorisë", theksoi

Ligji për pakicat në komision, Bushati: Garanton barazi

Edhe pse të gjitha forcat politike në vend e mbështetnin projektligjin e ri për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe në komisione deri më tani është miratuar nga të gjitha palët, duket se nuk ndodh e njëjta gjë me vendet e rajonit. Ky projektligj dhe mospërfshirja e minoritetit të saj ka vënë në lëvizje Ambasaden bullgare në Tiranë. "Realisht ndje-shmëria është e lartë. Vetëm pak ditë më parë në email-et tona ka mbërritur një kërkesë në adresë të komisionit edhe nga Ambasada bullgare, për t'u bërë e mundur që edhe ata të dëgjohej në këtë komision. Dhe ndoshta zonja kryetare është momenti që t'i kthejmë një përgjigje që dhe ata të vijnë nesër dhe të kenë mundësi të diskutojnë për këtë ligj", deklaroi deputetja e LSI, Klajda Gjoshja. Ndërsa ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati saktësoi se kjo letër ka mbërritur dhe në Komisionin e Ligjeve, por kërkoi nga deputetët që të jenë të unifikuar në qëndrimin e tyre. "Më gjithë respektin për letrat, duhet ta ndajmë shumë qartë parimin ndërkombëtar edhe parimin kushtetues, se cili quhet grup i interesit dhe grup që përfiton nga ky ligj dhe Komisioni i Politikës së Jashtme për vetë specifikën duhet ta ketë mirë parasysh këtë gjë. Shpresoj të jemi të unifikuar në këtë qëndrim", deklaroi Bushati. Në projektligjin e paraqitur në Kuvend për diskutim janë të parashikuara 8 pakica kombëtare në Shqipëri, të cilat do të dëgohen për qëndrimet e tyre mbi të ditën e martë, në një mbledhje të përbashkët të Komisionit të Ligjeve dhe atij të Punëve të Jashtme.



NJOFTIM

Pranë zyrës përmbartimore të shoq. "etebes" gjegj. adresa: Rr. "D. Hoxha" nr.915, Tirane, zbulohet kontakti i hapur në datën 11/02/2017, ora 15.30. Pasurite: shqiptare 1. Pas. kthull me nr. 706 Zk. 1042-S-5447m2 Nr. regjist. 11.1q.14.4. dhe pas. nr. 709 Zk. 1042-S-5447m2 m2 Nr. regjist. 11.1q.24. Zk. 1042-S-5447m2, me adrese: Ishbali Arameras Kruje-vlera filltare =5508300.

Të interesuarit të parqelien në adresën: Rr. "D. Hoxha" nr.915, Tirane. tel: 673019849; email: etebes@gmail.com

zj.Hysi. Gjithashtu, gjyqtarët kundërshtuan si antikush-tetuese edhe një nen të ligjit për organet e qeverisjes së drejtësisë që i jep të drejtë kryetarit të KLGJ-së, i cili nuk zgjidhet nga gjyqtarët të ketë dy vota, duke bërë shumicën në KLGJ.

Nisi në terren, aksioni për pastrimin e akseve rrugore nga ndërtimet e jashtëligjshme

Ornela Manjani

Biznese, kioska, tabela e çdo ndërtim tjetër që cenon sigurinë rrugore do të shembet. Aksioni nis dje dhe të përfundojë kur të jetë shembur çdo objekt që shkel distancat e përcaktuara në Kodin Rrugor për largësinë nga rruga. Autoriteti Rrugor Shqiptar, në bashkëpunim me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Policinë e Shtetit, filluan zbatimin e planit të masave, i cili nisi me aksin Tiranë-Vorë, për të vazhduar me akset e tjera. Te mbikalimi i Shkozetit, në Durrës, u ndërhy për heqjen e një biznesi që tregonte lule në një sipërfaqe toke pronë shtetërore. Afërsia e tij me rrugën është burim aksidentesh. "Përveç objekteve të biznesit si kioska, tabela etj., të gjitha llojet e aktiviteteve që janë në kundërshtim me Kodin Rrugor do të hiqen gjithashtu nga akset rrugore", deklaroi Afrim Qendro, drejtor i komanduar i ARRSH-së. "Paralelisht po punohet në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për të bërë njoftimet përkatëse dhe procedurat ligjore", tha Dallëndyshe Bici, drejtoreshë e IKMT-së. Ndërhyrje do të ketë edhe për pikat e karburanteve. "Do të lajmërohen të gjitha karburantet për t'i hequr tabelat e tyre dhe për t'i vendosur në funksion dhe zbatim të Kodit Rrugor, pasi kështu siç janë shmangin vëmend-

Qendro: Do të shemben biznese, kioska e tabela

Drejtori i ARRSH bën listën e objekteve që do të prishen



Afrim Qendro, drejtor i komanduar i ARRSH-së

jen e drejtuesve të mjeteve. Të gjitha karburantet që përdorin natën projektorë jashtë standardeve të rrugës duhet t'i heqin", nënvizoi Qendro. Qëllimi kryesor i aksionit është ulja e aksidenteve rrugore, që kanë si burim ndërhyrjet e paligjshme në akset kombëtare.

PARALAJMËRIMI

Ministri Damian Gjicknuri lajmëroi aksionin për pastrimin e nyjeve e akseve kombëtare. Në kuadër të Programit Qeverisës dhe prioritetëve të 100 ditëve të para, qeveria do të fillojë një operacion në terren, që synon pastrimin e nyjeve dhe hapësirave në akset krye-

sore kombëtare. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjicknuri bëri të ditur se përmes kësaj ndërhyrjeje do të mund të bëhet çmontimi i çdo strukture të aktiviteteve civile/ekonomike pa leje dhe gjithashtu pastrimi nga tabelat e ndryshme që, përveçse nuk kanë lidhje me sinjalistikën rrugore, e pengojnë atë dhe bëhen burim aksidentesh. Bazuar mbi hartat, listën e pikave të zeza të evidencuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar si dhe verifikimet në terren, janë duke u analizuar të gjitha pikat për ndërhyrje, duke i klasifikuar ato sipas riskut.

VKM

Në tetor të vitit të shkuar, qeveria ka miratuar një vendim ku ka rikualifikuar ndërtimet që legalizohen anash rrugëve. Do përfshihen në procesin e legalizimit ndërtimet që janë 30 metra larg kufirit të rrugës për autostradat dhe 20 metra larg kufirit të rrugës për akset interurbane kryesore. Çdo ndërtim që shkel këtë distancë, nuk kualifikohet për legalizim, pra do të shembet. Do të pajstrim me leje legalizimit ndërtimet që janë 10 metra larg kufirit rrugor në kategorinë C, rrugë interurbane dytësore; në kategorinë D, rrugë urbane kryesore dhe në kategorinë E, rrugë urbane dytësore.

DAMIAN GJICKNURI

"Autoriteti Rrugor Shqiptar, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Policia e Shtetit nisën sot punën në terren për pastrimin e nyjeve dhe akseve kombëtare nga tabelat, aktivitetet tregtare dhe sinjalistikat në kundërshtim me Kodin Rrugor. Ndërhyrja fillon në aksin Tiranë-Rrogozhinë-Vlorë, për t'u vazhduar më pas në akset e tjera. Shumë herë më e rëndësishme një jetë e kursyer në aksidente, sesa fitimet e çdo biznesi të paligjshëm që kryhet në anë të rrugëve ose poshtë nënkalimeve dhe mbikalimeve në akset rrugore", shkroi në "FB", ministri Damian Gjicknuri.

LARGËSIA NGA RRUGA, SIPAS KATEGORIVE

- A. Autostradë largësia nga kufiri i rrugës, 30 m
- B. Rrugë interurbane kryesore largësia nga kufiri i rrugës, 20 m
- C. Rrugë interurbane dytësore largësia nga kufiri i rrugës, 10 m
- D. Rrugë urbane kryesore merret për bazë vetëm trupi i rrugës
- E. Rrugë urbane dytësore merret për bazë vetëm trupi i rrugës

Fituesi zgjidhet pas 60 ditësh

Çelet gara, 3 kompani duan të ndërtojnë Rrugën e Arbrit

Tri kompani kanë shprehur interes për të ndërtuar Rrugën e Arbrit. Dy tetori ishte afati i fundit që Ministria e Infrastrukturës kishte lënë për të gjithë operatorët privatë që kishin interes për të ndërtuar këtë segment. "Gjoka Konstruktion" ka dorëzuar një ofertë për të përfunduar veprën me një shumë prej 250 milionë eurosh. Kjo firmë është favorite në garë, pasi ka bërë studimin e fizibilitetit, ndërsa në muajin prill u shpërblye me 10% të pikëve bonus. Interes ka shprehur edhe kompania "Alb-Star", e njëjta firmë që ka marrë përsipër ndërtimin e një veprë publike, siç është ajo e stadiumit "Qemal Stafa". Ministria e Infrastrukturës njofton se kjo shoqëri nuk ka bërë një ofertë financiare për vlerën e ndërtimit të veprës. Firma e tretë që ka dorëzuar ofertë është ajo e operatorit ekonomik Adem Pojani, por dokum-



mentet e këtij subjekti nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për t'u konsideruar një ofertë zyrtare. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka 60 ditë afat për të shqyrtuar dokumentacionin dhe më pas do të dalë me shpalljen zyrtare të fituesit. Segmenti i Rrugës së Arbrit do të jetë i gjatë 69 kilometra. Në tender është vendosur si kusht që kompania fituese nuk do të vendosë taksë për rrugën,

por pagesën për mirëmbajtjen do ta negociojë me palën shtetërore. Qeveria nuk do të pranojë oferta më të mëdha se 250 milionë euro, ndërsa kusht tjetër është që 190 milionë të kësaj veprë t'i japë ndërtuesi dhe 60 shteti. Në kohën që rruga do të përfundojë, atëherë kompania do të marrë me kështë paratë nga buxheti. Në bazë të projektit të rrugës, vepra pritet të përfundojë për 4 vite.

FMN publikon raportin: Koncesionet rrezik fiskal, detyrimet e prapambetura 120 mln euro

Fondi Monetar Ndërko mbëtar publikoi dje një raport për Shqipërinë, sipas të cilit është rishikuar rritja ekonomike për vitin 2017, nga 3.7% në 3.9%. Rritja e kërkesës së brendshme, projektet e mëdha të lidhura me investimet e huaja, turizmi në rritje dhe një rimëkëmbje e partnerëve tregtarë të BE-së janë faktorët që e bëjnë FMN-në optimiste për rritjen ekonomike. Në deklaratën përmbylëse të Artikullit 4, që është e para pasi marrëveshja trevjëçare e zgjeruar e mekanizimit të Fondit (EFF), që i mundësoi qeverisë shqiptare të merrte një hua prej 377,3 milionë eurosh, përfundoi në shkurt. Fondi shfaqet mjaft i ashpër: duke shprehur hapur shqetësimin për uljen e angazhimit të qeverisë në kuadër të konsolidimit fiskal, borxhet e fshehura që mund të lindin nga PPP-të, rikthimin e detyrimeve të prapambetura dhe ngadalësimin e ekonomisë vitin e ardhshëm, pas përfundimit të projekteve të mëdha. FMN është shprehur hapur edhe kundër bashkimit tati-me-dogana, pasi ai do të ndikonte në rendimentin e mbledhjes së të ardhurave. Teksa qeveria është angazhuar për një projekt investimesh të Partneritetit Publik-Privat (PPP), që mund të arrijë deri në 1 miliard euro, Fondi, në dek-



laratën e tij tërheq vëmendjen për rreziqet domethënëse fiskale që përmbajnë këto projekte. Fondi kërkon të ndikimi i këtyre projekte, ndryshe nga sa veprohet aktualisht, të reflektohet në logaritë fiskale dhe borxhin publik në mënyrë transparente dhe në linjë me normat ndërkombëtare. Ndonëse FMN e ka paralajmëruar vazhdimisht qeverisë që të bënte kujdes për të mos krijuar detyrime të reja të prapambetura, ato janë rritur sërish. Sipas deklaratës, deri në fund të qershorit, qeveria lokale dhe qendrore ka akumuluar detyrime të prapambetura që arrijnë në 1.1% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, që përfshin 0.3% të PBB-së si TVSH e parimbursuar. Teksa PBB është rreth 1.5 trilionë lekë, në vlerë absolute, detyrimet e prapambetura arrijnë në rreth 16.5 miliardë lekë, ose rreth 120 milionë euro. FMN pret që rritja ekonomike të ngadalësohet në 3.7% në vitin 2018, pasi investimet e mëdha të

lidhura me projektet e energjisë do të përfundojnë. FMN thekson se nevojiten masa shtesë për të mobilizuar burime për shpenzimet e rritura prioritare në shëndetësi, arsim dhe infrastrukturë. Efikasiteti tati-mor është i ulët në krahasim me vendet fqinje, duke pasqyruar pragje të larta tati-mor dhe nivel të ulët të përmbushjes së detyrimeve nga tatimpaguesit. Mbështetja shumë e lartë në tati-me të veçanta ka çuar gjithashtu në elasticitet të ulët tati-mor në raport me PBB-në. Misioni e mirëpret zbatimin e planifikuar të një tati-mor mbi pronën që mbështetet në vlerën e pronës dhe përmirësimin e përmbushjes së detyrimeve tati-mor dhe rekomandon masa të tjera shtesë si indeksimi i akcizave sipas inflacionit për të ruajtur vlerën reale, taksën e transferimit të pronësisë si hap tranzitor drejt futjes së tati-mor të bazuar në vlerën e pronës, akcizat mjedësore dhe zgjerimin e bazës tati-mor.


27-vjeçari menaxher i një supermarketi, luajti në baste sportive me paratë e xhiros ditore

Xhensila Kodra

Një 27-vjeçar nga Tira na është vënë në prangat e policisë sepse, pasi kishte harxhuar 5 milionë lekë të vjetra në disa pika bastesh sportive, sajoi se e kishin grabitur. Burime zyrtare të policisë bënë dije me dije se i arrestuari është shtetasi Albi Çeliku. Ky i fundit ishte i punësuar si menaxher i një supermarketi në zonën e Brryllit, ndërsa paratë që kishte harxhuar në 3 skedina të ndryshme ishin të xhiros ditore të ditës së diel. I riu i kishte marrë paratë nga punonjësit e marketit për t'i dorëzuar ato në kompaninë qendrore. Por, mëngjesin e djeshëm, ai ka lajmëruar policinë se 3 persona të maskuar dhe me armë i kishin prerë atij rrugën dhe nën kërcënimin e një pistolette i kishin marrë çantën me para. Pas këtij denoncimi, policia u vu në lëvizje për të zbuluar autorët, nga ku rezultoi më tej, se pikërisht në rrugën ku Çeliku pretendonte të ishte grabitur, kamerat e sigurisë të asaj zone nuk kishin fiksuar asnjë ngjarje të tillë. I ndodhur në këtë situatë, 27-vjeçari është marrë sërish në pyetje nga uniformat blu, ku ka pranuar se grabitja ishte inskenuar prej tij, pasi shumën e leëve e kishte harxhuar në

Harxhoi 5 mln lekë në 3 skedina e sajoi grabitje, arrestohet i riu

Albi Çeliku: 3 persona më kërcënuan me armë



Supermarketi ku punonte 27-vjeçari i arrestuar

disa baste sportive, mbrëmjen e së dielës. Pas kësaj, policia vuri në pranga Albi Çeliku, duke akuzuar atë për "Kallëzim të rremë".

DËSHMIA
Albi Çeliku, banues në Tiranë, është paraqitur në polici rreth orës 10:50, ku ka

bërë denoncim se 3 persona, nën kërcënimin e një arme i kishin marrë atij çantën me 5 mln lekë. "3 persona të maskuar më prenë rrugën dhe duke më kërcënuar me armë më morën çantën në të cilën kisha 5 milionë lekë. Paratë ishin të xhiros ditore

të një supermarketi ku unë jam i punësuar si menaxher dhe duhej t'i goja në kompaninë qendrore", - ka thënë fillimisht 27-vjeçari. Mandej, i shoqëruar sërish në komisarjat, i riu ka pranuar se këtë shumë parash e kishte harxhuar për skedi-

HETIMI

Nga hetimet kryera nga policia rezultoi se 27-vjeçari, shumë prej 5 milionë lekësh të vjetra e kishte lënë në disa pika bastesh sportive. Nga ana e shërbimeve të policisë janë dokumentuar edhe ambientet se ku Albi Çeliku kishte humbur këtë shumë parash.

nat e basteve që kishte luajtur mbrëmjen e së dielës. Ky lloj mashtrimi i kushtoi shtrënjtë të riut, i cili u arrestua menjëherë nga policia, ndërsa tashmë i duhet t'i paguajë kompanisë ku ai punonte edhe shumën e parave që ka harxhuar.

NGJARJA



Përfshihet qëllimisht nga flakët makina e të riut

TIRANË - Automjeti i një 30-vjeçari është përfshirë nga flakët, ndërsa policia ka dyshime se ngjarja mund të ketë qenë e qëllimshme. Burime pranë uniformave blu bënë me dije se mjeti në fjalë i përket shtetasit me inicialet A.Z. Ngjarja është shënuar në rrugën "Vangjush Furxhi", ku ka marrë flakë mjeti tip "Toyota". Hetimet janë përqendruar në ndonjë konflikt që i riu mund të ketë pasur, ndërsa kanë nisur punën për identifikimin dhe kapjen e autorëve.

SHKURT



Burri vret me thikë gruan në banesë, arrestohet

GJERMANI - Një grua 27-vjeçare që jetonte në Siegburg të Gjermanisë, është vrrarë nga burri i saj 36-vjeçar. Sipas raportimit të mediave gjermane, autori i ngjarjes është paraqitur në stacionin e policisë duke pranuar fajësinë, ku më pas u arrestua nga policia. Viktima dhe bashkëshorti i saj janë koso-varë nga Vushtrria. Sipas fqinjëve, çifti jetonte në një apartament në ndërtesën e pasme për disa muaj. Siç raportohet, burri ka punuar në një resto-rant aty pranë apartamentit. Madje fqinjët e kanë përshkruar si një çift të pakuptimtë dhe se mëngjesin e ditës së djeshme ata ishin grindur, raporton "ksta.de". Gjithashtu, në raportim bëhet i ditur edhe fakti se 36-vjeçari në momentin e ngjarjes kishte thirrur edhe Emergjençën, duke u thënë se kishte sulmuar gruan e tij. Trupi i pajetë i bashkëshortes u gjet në ndërtesë, ku edhe mjekët konfirmuan vdekjen e saj. Ai e kishte qëlluar gruan e tij me një thikë, ku ishin gjetur edhe njolla gjaku te 36-vjeçari.

CALL FOR EXPRESSIONS OF INTEREST

As an international cooperation enterprise for sustainable development with worldwide operations, the federally owned Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH supports the German Government in achieving its development-policy objectives. It provides viable, forward looking solutions for political, economic, ecological and social development in a globalised world. GIZ promotes complex reforms and change processes. Its corporate objective is to improve people's living conditions on a sustainable basis.

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, is announcing as following:

Call for expressions of interest

The GIZ project in Kosovo "Sustainable Municipal Services (SMS 2.0)" invites qualified companies to submit expression of interest in providing framework consultancy services for capacity development in waste management.

The amended Waste Law (2012) is the legal base for municipal waste management activities in Kosovo. According to this Law, municipalities have the full mandate for provision of municipal waste management services within their territory and in order to meet fulfil this obligation and carry out reforms public administration and public company officials need to possess the required knowledge and skills. With this in mind, education and training of waste management actors in the country is one of the main focuses of the current programme. In cooperation with KIPA (Kosovo Institute for Public Administration) training sessions are planned during 2017 that will officially certify waste managers in the country. This entails the development of training modules for the waste officials, development of modules for the Training of Trainers, and oversight of the first training session together with the newly certified KIPA trainers.

The checklist below provides further information about the conditions and expectations of the GIZ/SMS project. Based on responses to this Request for Information, GIZ will pre-qualify companies that will receive an inquiry and will be formally invited to submit their offers with detailed specifications. Response to the RFI (Request for Information) does not necessarily imply that your company will receive the GIZ's "Request for Capacity Development in Waste Management".

Based on the outcome of offers, GIZ/SMS project will offer a framework contract to the selected company. Please note that all correspondence and dealing with the GIZ must be in English language.

REQUEST FOR INFORMATION

- 1) Proof of company's legal status (registration and/or certification documentation), company details (name, postal address bank information etc.), date of incorporation within their initial response.
- 2) Companies should submit references to whom they have provided similar products as required by the GIZ/SMS project. Companies should note that referees may be contacted by the GIZ/SMS project at any time.

Interested companies are invited to submit expression of interest in [English language](#).

The deadline for submitting the application is 12.10.2017 through a closed envelope to GIZ offices in Pristina, Rr. Anton 'etta Nr.1, 10000 Pristina/Kosovo labeled "Expression of Interest in providing framework consultancy services for capacity development in waste management - VN:83268832".

Only shortlisted companies will be notified for further application procedures!

Vendi ku ndodhi ngjarja

Agresorët e maskuar: S'merr fund me kaq

Goditet me mjete të forta ish-kreu i SHIK-ut, Artan Dauti

BERAT - Ish-kreu i SHIK-ut në Berat, Artan Dauti është sulmuar dhe goditur mbrëmjen e djeshme nga dy persona ende të paidentifikuar, ndërsa ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 18:30, në lagjen "28 Nëntori" të këtij qyteti, pranë banesës së nënës së 48-vjeçarit. Mësohet se pas afro 20 vitesh, Artan Dauti ishte kthyer nga Italia në Shqipëri para tri ditësh për të takuar familjarët e tij. Ai ishte duke udhëtuar me një makinë që ia kishte marrë një shoku të tij drejt lagjes ku banonte e ëma, kur është sulmuar nga dy persona të maskuar. Mësohet se Dauti është sulmuar në momentin që ka zbritur nga makina në një nga rrugicat e lagjes në fjalë. Ai është goditur barbarisht nga dy agresorët me mjete të forta. Zhurma e përleshjes është dëgjuar nga klientët e një lokali afër vendit të ngjarjes, të cilët kanë shpejtuar të shohin se çfarë po ndodhte. Në këtë moment, dy personat e maskuar janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes, ndërsa i kanë thënë ish-kreut të SHIK-ut se "kjo nuk merr fund me kaq". I plagosuri është dërguar në spitalin rajonal të Beratit, ku dhe i është dhënë ndihma e parë mjekësore. Pas sinjalizimit për plagosjen, policia ka shkuar shpejt në vendngjarje dhe ka nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Ndërkaq, gjatë marrjes në pyetje 48-vjeçari ka thënë: "Më goditën sapo zbrita nga makina, dyshoj që ishin dy persona". Artan Dauti ka shërbyer si shef i SHIK-ut në Berat në vitet 1993-1996, ndërsa prej vitesh jetonte në Itali bashkë me familjen. **en.pe.**

I dënuari me 20 vjet burg në Itali u lirua më 11 korrik

Gjyqtari Petraq Curri tërhiqet nga çështja e "baronit të drogës", Alket Hatia

DURRËS - Afro tre muaj pas lirim të Alket Hatias, i cili është dënuar me 20 vite burg në Itali, gjyqtari Petraq Curri është tërhequr dje nga gjykimi në çështjes. Burime për "GSH" bënë me dije se gjyqtari në fjalë e ka justifikuar vendimin e tij me këto fjalë: "U tërhoqa, pasi nuk dua të paragjykojem". Si argument për t'u tërhequr nga kjo çështje, Curri ka përdorur një inspektim që Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka nisur ndaj vendimit të lirim të Hatisë, vendim, i cili është marrë nga vetë gjyqtari më 11 korrik të këtij viti. 45-vjeçari Alket Hatia është etiketuar nga mediat italiane si "baron i drogës".

ARRËSTIMI

Në njoftimin e Policisë së Shtetit në datë 8 korrik dek-



Gjyqtari Petraq Curri

TRAFIKU I DROGËS

Sipas mediave italiane, hetimet e policisë italiane kanë vërtetuar se nga janari i vitit 2003 deri në mars të 2004-ës, Alket Hatija kishte trafikuar në qytetin e Milanos rreth 350 kg heroinë e 190 kg kokainë me vlerë 35-40 milionë euro. Ai qëndronte i fshehur në një vilë me bunker në qytetin e Beratit ku ruhej nga disa truproja të armatosur, ndërsa u arrestua në Durrës teksa do të takonte një mik.

larohet se Alket Hatia është dënuar më 30.09.2015 me 20 vite burg në Itali për trafik droge. "Gjykata e Apelit në Itali me Vendimin Nr. 4526, datë 30.09.2015 ka caktuar

masën e dënimit me 20 vjet burgim, në ngarkim të shtetasit të mësipërm për veprën penale "Trafikimi i lëndëve narkotike" e kryer në bashkëpunim, parashikuar në

nenet art.110, art.73, 73/6, 80/2 të Kodit Penal Italian dhe Dekretit Nr. DPR 309/90", thuhet në njoftimin për mediat të policisë. 45-vjeçari akuzohet nga gjykata e Milanos në Ita-



Alket Hatia

li se ka futur 350 kg heroinë dhe 190 kg kokainë në vitet 2002-2003 nga Shqipëria me një rrjet të superorganizuar.

LIRIMI

Gjykata e Shkallës së Parë në Durrës e ka cilësuar si të paligjshëm dhe të pambështetur në prova arrestimin e Alket Hatias, duke e liruar nga burgu më 11 korrik. Sipas vendimit të gjykatës, Alket Hatia është dënuar me 23 vite burg për disa vepra pe-

nale për trafikim droge drejt Italisë dhe krijim të organizatave kriminale. Pas përfundimit të dënimit, ai është liruar. Pala mbrojtëse pretendon se nuk i është hequr emri nga sistemi. Në përfundim të shqyrtimit të dosjes, gjykata vendosi që ta linte të lirë 45-vjeçarin, pasi e ka kryer një dënim në Shqipëri për akuzat nga shteti italian, por prokuroria e ka apeluar vendimin. **kl.ha.**

Arrin në 30 numri i të shoqëruarve. Policia: Po hetojmë në pistën e hakmarrjes

Arrestohet objektivi i atentatit në Vlorë, Llanaj: Spashë kush na qëlloi

"Lëvizja i armatosur, pasi duan të më heqin qafe"

SHKURT

U vetëplagos me kallashnikov, bie në pranga 40-vjeçari

VLORE - Policia e Vlorës ka zbardhur ngjarjen e ndodhur mbrëmjen e së dielës në fshatin Vranisht, ku u plagos një 40-vjeçar. Pas kryerjes së hetimeve paraprake ka rezultuar se Roland Shkurti, nën efektin e pijeve alkoolike është vetëplagosur me armë zjarri tip kallashnikov. Si pasojë, ai ka marrë dëmtime në pjesë të trupit dhe aktualisht është duke marrë mjekimin e nevojshëm në Spitalin Rajonal Vlorë, jashtë rreziqut për jetën. Në përfundim të hetimit dhe dokumentimit të ngjarjes, policia ka bërë arrestimin në flagrancë të këtij shtetasi për veprën penale: "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë".

Arrestohen 2 persona, ish-in në kërkim për kultivim droge

SHKODËR - Dy persona të shpallur në kërkim për kultivim droge janë arrestuar dje nga policia e Shkodrës. Bëhet fjalë për 31-vjeçarin Altin Logu, banues në lagjen "Ndoc Mazi" të qytetit verior dhe shtetasin Qani Hamzaj, banues në Tiranë. Sipas bluve, Logu u kap pasi Gjykata Apelit Shkodër e ka dënuar me 7 vite burg me vendim nr. 237, për veprën penale: "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike". Ndërsa, 40-vjeçari Hamzaj u arrestua, pasi Gjykata e Apelit Shkodër me vendim të formës së prerë, nr. 513 datë 20.09.2017, e ka dënuar me 3 vite e 8 muaj burg për veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike e kryer në bashkëpunim".

VLORE

Nuk i pashë personat që na qëlluan me breshëri kallashnikov. Dyshoj se atentati ndodhi për hakmarrje. Duan të më heqin qafe, ndaj dhe lëvizja i armatosur për t'u vetëmbrojtur". Kështu ka deklaruar në polici 39-vjeçari Ferdinand Llanaj, i cili u sulmua paraditen e së dielës në rrugën "Transballkanike", në lagjen "Pavarësia" të qytetit të Vlorës. Në këtë ngjarje të rëndë u plagos dhe djali i tij 8-vjeçar, B.Llanaj si dhe mik i tij, Dritan Begaj 50 vjeç. Pas atentatit që tronditi banorët e qytetit bregdetar, policia ka arrestuar Llanajn, i cili dyshohet se ka qenë objektivi i autorëve të krimit. Burime zyrtare nga policia e Vlorës dje bënë me dije se 39-vjeçari edhe pse i plagosur (ka marrë dy plumba në trup) dhe po mjekohet në spital është në gjendje arresti, pasi akuzohet për armëmbajtje pa leje. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake ka rezultuar se pistoletat model 56 që u gjet pranë automjetit të tij "Mercedes-Benz" me targa VL 6368C, i përket pikërisht Ferdinand Llanajt, çka do të thotë se 39-vjeçari u është kundërpërgjigjur me zjarr atentatorëve të tij. Ndërkaq, mësohet se një ditë pas plagosjes së trefishtë, numri i personave të shoqëruar nga policia në lidhje me këtë ngjarje ka arritur në 30. Sipas hetuesve të çështjes, mes personave të shoqëruar dhe të marrë në pyetje kanë qenë edhe familjarë të fisit Xhaferaj nga Selencia si dhe të afërm të personave të përfshirë në masakrën e Çoles, ngjarje e ndodhur dy vite më parë në këtë qytet.



Makina ku u plagosën tre personat në Vlorë



Pistoleta e sekuestruar në vendin e ngjarjes

I plagosuri Dritan Begaj: U munduam të mbroheshim nga plumbat

VLORE - Në atentatin e së dielës mbeti i plagosur dhe 50-vjeçari Dritan Begaj. Gjatë marrjes në pyetje nga policia, ai ka pohuar se "mëngjesin e së dielës shkova dhe mora në shtëpi Ferdinandin. Gjatë rrugës nuk vumë re ndonjë person të dyshimtë. Sapo dolëm në rrugën kryesore, dëgjua breshërinë e plumbave që vinin drejt nesh. U munduam të mbroheshim me aq sa mundeshim për të mbijetuar. Në atë moment nuk i pashë personat që na qëlluan".

mbledhur dhe siguruar prova nga vendi i ngjarjes, me qëllim për të bërë të mundur një dokumentim sa më të plotë të rrethanave të saj. Sipas bluve, janë siguruar prej bizneseve pranë kësaj zone të gjitha kamerat, të cilat mund të ndihmojnë në

zbardhjen e fakteve dhe sqarimin e dokumentimit e plotë të ngjarjes. Gjithashtu, në vendngjarje policia ka sekuestruar një pistoletë, një predhë arme zjarri model 56-kalibrë 7.62mm, automjetin tip "Mercedes Benz" dhe një tjetër mjet "Renault

Clio", disa aparate celularë dhe një shumë prej 1.600.000 lekësh. Po të njëjtat burime u shprehën se automjeti "Renault Clio" u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, pasi është prekur nga plumbat e kallashnikovit të atentatorëve. Mësohet se ky mjet nuk ka lidhje me dinamiken e ngjarjes, por ishte i parkuar pranë vendit të krimit. Nga ana tjetër, grupi hetimor po punon edhe në lidhje me makinën e djeur tip "BMW", që u gjet dy orë pas atentatit në fshatin Kafaraj të Fierit, ku brenda së cilës u gjetën dy kallashnikovë dhe 3 gëzhoja model 56-kalibrë 7.62mm. Ekspertët do të analizojnë dy kallashnikovët e gjetur në këtë makinë, ndërsa ka dyshime të forta se armët dhe mjeti u përkasin atentatorëve të Ferdinand Llanajt. Pista

kryesore ku po hetohet është ajo e hakmarrjes, por në dy drejtime të ndryshme. E para është ajo e konflikteve e masakrës së Çoles që u shënuar në vitin 2015, ku vëllai i Ferdinand Llanajt, Aleksandri së bashku me miqtë e tij Ani Begaj dhe Bertil Aliaj vranë 3 të rinjtë: Akil Hasanaj, Ardi Velaj dhe Albi Limaj. E lidhur me këtë histori sipas burimeve të policisë, është edhe vrasja e biznesmenit Erven Hyseni në Sheshin e Flamurit në Vlorë, ku mbeti i vdekur aksidentalisht edhe drejtori i OSHEE në Vlorë, Roland Saliu. Erven Hyseni ishte daja i një prej të vrarëve të masakrës së Çoles.

Pista e dytë është zinxhiri i hakmarrjeve që familja Llanaj ka me familjen Xhaferri në Selenicë, që ka shkaktuar 3 të vrarë.

Operacion antidrogë/ Policia, dyshime për përfshirje të personave të tjerë në trafik

Sekuestrohen 712 kg kanabis në Otranto, në pranga 3 skafistë shqiptarë

Dyshohet se droga do kalohej nga Greqia në Itali

Një sasi prej 712 kg lëndë narkotike kanabis është sekuestruar dje në afërsi të Otrantos, gjatë një operacioni ndërkombëtar antidrogë mes policisë greke, shqiptare e italiane. Gjatë operacionit ranë në pranga 3 skafistë shqiptarë, të cilët ndodheshin në gomone. Policia Kufitare greke ka njoftuar Policinë e Shtetit për një gomone, që dyshohej se po trafikonte lëndë narkotike nga Greqia për në Itali. Menjëherë, Policia Kufitare e D.P.V. Vlorë ka shkëmbyer informacion me kolegët e policisë italiane, Guardia di Finanza në Durës dhe Vlorë, si dhe me Zyrën Ndërlidhëse të Policisë së Shtetit në Itali në një komunikim të vazhdueshëm me Guardia di Finanza në Bari dhe Puglia. Ndërkohë, Policia e Shtetit ka aktivizuar në det dhe në terren të gjitha shër-



Droga e sekuestruar dje në afërsi të Otrantos

bimet e Policisë Kufitare, Delta Force, si dhe ka njoftuar QNOD dhe Rojën Bregdetare, e cila ka nxjerrë menjëherë në det shërbime në ndihmë të Policisë së Shtetit. Më pas, ka qenë Guardia di Finanza e Pulias, që ka bërë të mundur që në orët e para të mëngjesit të djeshëm në afërsi të Otrantos të ndalojë gomonen me tre shqiptarë në bord dhe

sasinë e madhe të drogës. Konkretisht, kanë rënë në pranga tre shtetasit shqiptarë me inicialet: L.B. 38 vjeç, H.M. 23 vjeç dhe Xh.H. 24 vjeç. Gjithashtu, Guardia di Finanza e Pulias ka gjetur e sekuestruar në bordin e gomones 712 kg lëndë narkotike kanabis sativa. Mësohet se po vijon shkëmbimi intensiv i informacionit mes tre

Arrestimi

Guardia di Finanza e Pulias ka bërë të mundur që në orët e para të mëngjesit të djeshëm në afërsi të Otrantos të ndalojë gomonen me tre shqiptarë në bord dhe një sasinë prej 712 kg kanabis. Konkretisht kanë rënë në pranga tre shtetasit shqiptarë me inicialet: L.B. 38 vjeç, H.M. 23 vjeç dhe Xh.H. 24 vjeç.

policive për zbardhjen e plotë të këtij rasti, si dhe për identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të përfshirë në këtë trafik. Nga veprimet paraprake dyshohet se gomonen e ka çuar në Greqi një shtetas italian, me qëllim trafikun të lëndëve narkotike, që do të kalonin nga Greqia për në Itali me skafistë nga Shqipëria. In.all



Kapet me 32 kg heroinë dhe armë në Itali, arrestohet shtetasi shqiptar

Guardia di Finanza në Komo arrestoi një shtetas shqiptar, pasi iu gjet dhe iu sekuestrua një sasi prej 32 kg heroinë në banesën e tij. Gjatë një kontrolli normal rrugor, punonjësit e policisë italiane kanë ndaluar shtetasin shqiptar për verifikim. Mësohet se shqiptari duke iu përgjigjur pyetjeve rituale ka treguar nervozizëm të tepruar, duke i lënë oficerët me dyshime. Gjatë kontrollit të makinës, iu gjet një kaçavidë në kroskot, policët shtuan dyshimet dhe janë thelluar për kontroll më të imtësishtë të mjetit. Më tej, Guardia di Finanza zbuloi dy funde të dyfishta në brendësi të makinës, njëri nën kambio dhe tjetri pas kroskotit. Policia bën me dije se pas kroskotit, në brendësi të makinës është gjetur një revolver me municione. Gjatë një verifikimi të kryer nga Guardia di Finanza mësohet se arma ka rezultuar e vjedhur në vitin 2010. Më pas gjatë kontrollit, forcat policore gjetën një tufë me çelësa të shtëpisë së shqiptarit në një lagje në Brebiate, në provincën e Bergamos. Gjatë verifikimeve të kryera në banesën e shqiptarit u zbulua një laborator droge. Në brendësi u gjetën 63 pako me heroinë, në total mbi 32 kg. Po kështu u gjetën dhe u sekuestruan edhe dy pistoletë, nga të cilat njëra e përshtatur me silenciator dhe me matrikull gjysmë e gërvishitur; 108 fishkë të kalibrut të ndryshëm, mbi 40 kg substancë përzierës dhe të gjitha mjetet e përdorura për drogën. Gjithashtu, policia ka sekuestruar edhe 2 autovetura. Mësohet se shtetasi shqiptar ka rezultuar me precedentë penalë për armëmbajtje.



NJOFTIMI I ANKANDIT

- Autoriteti shites:** Albpetrol sha Patos, Rruga Fier – Patos km 7
- Data e zhvillimit te ankandit:** 03/10/2017
- Lloji i Procedurës standarde te ankandit:** Procedure e hapur
- Objekti i Shitjes:** Shitje gaz shoqerues, sasia 3 000 000 Nm³
- Afati i evadimit:** 600 000 Nm³ brenda 1 viti nga data e nenshkrimit te kontrates dhe 3 000 000 Nm³ brenda 5 viteve nga data e nenshkrimit te kontrates.
- Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes:** Shitje gaz shoqerues, sasia 3 000 000 Nm³, gaz i prodhuar ne vendburimin Cakran Mollaj.
- Vlera fillestare:**
Cmimi= 0,8 x TTF + K
 - TTF eshte cmimi ne euro/mwh i gazit shoqerues te publikuar ne bursen hollandeze.
 - K- eshte vlera euro/mwh e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal te shitjes te perlogaritur nga formula (Ke⁰).
 - Per konvertimin e cmimit nga euro/mwh ne euro/Nm³ per gazin e vendburimit Cakran Mollaj do te perdoret koeficienti 0.00781.
- Vendndodhja e gazit shoqerues:** Albpetrol sha Patos Vendburimi Cakran Mollaj
- Vendi i zhvillimit te ankandit:** Ministria e Energjise dhe Industrise, Sheshi Skenderbej, Tirane, salla e mbledhjeve kati I-re.
- Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: ne zyren e protokollit te Ministrise se Energjise dhe Industrise, datë 03/10/2017, ora 11:00**
- Informacion mbi dokumentet e ankandit:** Dokumentet e ankandit mund te terhiqen prane autoritetit shites me paraqitjen e nje kerkese me shkrim ose ne faqen zyrtare te "Albpetrol" sha www.albpetrol.al dhe ne faqen e Ministrise se Energjise dhe Industrise www.energija.gov.al.
Dokumente me pagesë:
Po Jo X
- Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me poste ose dorazi, perpara dates dhe ores se zhvillimit te ankandit, ne vendin e përcaktuar ne dokumentet e ankandit.**

TRASHEGIMIA

NDËRTIM NË BUTRINT

Berisha: Rama po bën vilë familjare. Ministria: Është godinë ekzistuese

Imazhe të çimentos e tulave në Parkun Kombëtar të Butrintit kanë bërë xhiron e rrjeteve sociale dhe mediave ditën e djeshme. Më pas, ka qenë ish-kryeministri Sali Berisha që përmes një postimi në faqen e tij zyrtare në "Facebook", ka shkruar se Rama po ndërton vilë familjare brenda në Butrint. "Lexoni mesazhin dhe shikoni fotot e qytetarit dixhital. s.b.", shkruante Berisha, duke shënuar më pas se, sipas informacioneve të tij, "një skandal i madh po ndodhte në Butrint, disa media dhe portale e fshinë lajmin. Thuhet se ndërtimi brenda në park është i njërit nga lart, vetë kryeministrit, skandal i dyfishtë". Orë më vonë, ka reaguar Ministria e Kulturës. Teksa mohonte këto akuza, Ministria e Kulturës ka deklaruar se "në Parkun Kombëtar të Butrintit nuk janë duke u kryer gërmime apo ndërtime të reja, por në bazë të vendimeve ligjore dhe teknike janë duke u përshtatur objektet ekzistuese, me qëllim përdorimin e tyre për kryerjen e shërbimeve të standardizuara brenda Parkut".

Sakaq, gjithnjë e më shumë ministria Mirela Kumbaro shpreh se "ne nuk duhet të kemi frikë të jetojmë brenda trashëgimisë. Kjo është arsyeja pse po punojmë fort për trashëgiminë si motor zhvillimi, që do të thotë më shumë të ardhura. Në 4 vjet kemi bërë të mundur që trashëgimia të kthehet në burim ekonomie". Ministria e Kulturës thekson se prej shumë vitesh në Parkun Kombëtar të Butrintit është konstatuar se ofroheshin shërbime tregtimi të cilat nuk respektonin legjislacionin përkatës fiskal, legjislacionin mbi sigurinë e produkteve ushqimore, legjislacionin mbi produktet kozmetike etj., në mungesë ndër të tjera edhe të kushteve higjieno-sanitare.

Më herët, drejtori i Parkut Arkeologjik, Gjergji Mano bënte të ditur për median se leja për ndërtimin brenda zonës së mbrojtur është dhënë nga Ministria e Kulturës. Sipas raportimeve të mediave gjatë paradites së djeshme, ndërtimi po bëhet pranë një muri prehistorik, i cili daton në shekullin e 7-8 para Krishtit. Të njëjtat raportime, shënonin se ob-



Ndërtimi që po bëhet në Parkun Kombëtar të Butrintit

Fotot dhe deklaratat, "po kryhet përshtatja e ambienteve ekzistuese në përputhje me parametrat e konventat e UNESCO-s"

jektet po ndërtohet në Akropolin e qytetit të lashtë të Butrintit, pranë Kullës Veneçiane, e cila është më e larta në Butrint. Nga reagimi i ministrisë, këto të dhëna as nuk përgënjeshetrohen, as nuk konfirmohen.

REAGIMI I PLOTË

Pas raportimeve të bëra në media mbi ndërtime në Parkun Kombëtar të Butrintit, Ministria e Kulturës përmes një deklaratë me email, shkruante se "në Parkun Kombëtar të Butrintit nuk janë duke u kryer gërmime apo ndërtime të reja, por në bazë të vendi-

meve ligjore dhe teknike janë duke u përshtatur objektet ekzistuese me qëllim përdorimin e tyre për kryerjen e shërbimeve të standardizuara brenda Parkut

Ka qenë ish-kryeministri Sali Berisha që përmes një postimi në faqen e tij zyrtare në "Facebook", ka shkruar se Rama po ndërton vilë familjare brenda në Butrint. "Lexoni mesazhin dhe shikoni fotot e qytetarit dixhital. s.b.", shkruante Berisha, duke shënuar më pas se, sipas informacioneve të tij, "një skandal i madh po ndodhte në Butrint, disa media dhe portale e fshinë lajmin".

Kombëtar të Butrintit". Ministria e Kulturës thekson se prej shumë vitesh në Parkun Kombëtar të Butrintit është konstatuar se ofroheshin shërbime tregtimi të cilat nuk respektonin legjislacionin përkatës fiskal, legjislacionin mbi sigurinë e produkteve ushqimore, legjislacionin mbi produktet kozmetike etj., në mungesë ndër të tjera edhe të kushteve higjieno-sanitare.

"Në kuadër të rritjes së cilësisë dhe standardizimit të shërbimeve të ofruara në sitet e Trashëgimisë Kulturore prej tashmë 4 vitesh, Ministria e Kulturës ka ndërmarrë një sërë aksionesh dhe nismash në linjë edhe me nismat e tjera si:

rritja e sigurisë në përshkueshmërinë e itinerareve turistike brenda parqeve kombëtare; përmirësimi dhe funksionimi i nyjeve higjieno-sanitare, infrastruktura cilësore të aksesueshmërisë dhe pritjes së vizitorëve etj".

Sqarimi vijon me një theksim të veçantë të faktit që, sipas saj, "në këtë kontekst, për të zgjidhur problematikën, në vitet 2015 dhe 2016 Ministria e Kulturës ka miratuar dy udhëzime specifike, të cilat janë hartuar në bazë të ligjit të Trashëgimisë Kulturore (publikuar në Fletoren Zyrtare dhe website e Ministrisë së Kulturës), me qëllim standardizimin dhe miradmirimin e siteve të Trashëgimisë Kulturore. Hartimi dhe fazat e zbatimit të këtyre udhëzimeve kanë kaluar përmes një sërë konsultimesh me grupet e interesit dhe komunikimeve publike".

Thuhet më tej se, në zbatim të këtyre Udhezimeve dhe për të zgjidhur problematikën më sipër, Ministria e Kulturës dhe institucionet e saj teknike vendimmarrëse kanë miratuar projektet mbi infrastrukturën e standardizuar të ofrimit të shërbimeve në dy qendra specifike të cilat ofrojnë shërbimet e tyre brenda Parkut Kombëtar të Butrintit. Qendra SAL (Souvenir-Art-Libra) dhe Qendra Multifunktionale Shërbimesh, të cilat do tregtojnë vetëm produktet e miratuara dhe të certifikuara paraprakisht nga Ministria e Kulturës.

"Edhe një herë Ministria e Kulturës sqaron opinion publik se asnjë godinë e re nuk ndërtohet në Parkun Kombëtar të Butrintit, por është duke u kryer përshtatja e ambienteve ekzistuese me struktura të përkohshme dhe në përputhje me të gjithë parametrat e parashikuar nga konventat e UNESCO-s. Ashtu siç dhe parashikohet në vendimin nr. 712/3, datë 25.05.2017, të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, dhe vendimit nr. 149, datë 12.05.2017, të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, të cilët miratojnë projektin me titull "Rehabilitimi dhe ndërtimi i pikave të shërbimit në Parkun Antik të Butrintit", projekt i miratuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës".



IN MEMORIAM

LAMTUMIRË, ROBERT ELSIE!

Parandjenja, “pas 30 vitesh, nëse do jemi gjallë...”

Fatmira Nikolli

Më hidhërim të thellë, një tojmë vdekjen e para kohshme të Dr. Robert Elsie në Berlin, më 2 tetor 2017, nga sëmundja e rrallë e neuroneve motorike. Stefan Trierwiler, partneri i tij i jetës, dhe Artur Metani, mik i ngushtë. Mbase edhe për disa kohë ky do të jetë njoftimi që do lexojmë kur të klikojmë në “elsie.de” bibliotekën virtuale të kulturës shqiptare.

I qetë, i qeshur, i urtë, i pazë, modest e timid, pa rrahur gjoksin, larg skenave e projektoreve, fjalë-pakë e punëshumë, qëntoi për vite të gjata dëshmi të kulturës shqipe, në biblioteka e arkiva, anekënd botës. Me durimin e kërkimit të një gjilpërë në kashtrën e madhe, mblodhi dëshmi të shqipes së shkruar e të folur, të historisë e fotografisë, të letërsisë e rrëfimeve, duke hedhur dritë mbi historinë e vendit tonë, që u bë i tij, falë një ngulmimi të pashtershëm për të nxjerrë në dritë gjithë çfarë shekujt kishin mbuluar e fshehur. U bë zëdhënës i kësaj kulture që strukej në një gjuhë të bukur, por të vështirë e të panjohur - i dha zë duke e përkthyer në anglisht e gjermanisht që të kishte qasjen e gjithë botës. Vendosi të ikë në heshtje, pa marrë keqardhjen e askujt. Vuajti pak muaj, derisa dje Robert Elsie bëri gjëmën e madhe, duke u ndarë nga jeta papritur, kaq shpejt, krejt pabesisht e para kohe e duke lënë bosh një vend të rëndësishëm e të respektit të pazëvendësueshëm. Bëri i vetëm e pa buxhete më shumë se ç'kanë bërë disa titullarë me fonde të majme. Ai burrë që ikën, ai burrë që na ktheu shpinën, për gjithë ç'ka bërë na ka prerë krahët, duke na lënë pothuaj “jetimë”. Pati qarë kur në Hagë përkthente në gjyq krimet e serbëve në Kosovë, mandej me të folmen me dialekt Kosovë, udhëtoi, incizoi e pra dokumentoi e dha dëshmi të pakontestueshme për Kosovën, Shqipërinë, copëzat e Shqipërisë të mbetura jashtë kufijve, për arbëreshë e arvanitë, për çamë e arbëreshë të Zarës.

“Harta e gjuhës, natyrisht s'do të jetë asnjëherë e plotë, por doja të prezantoja gjuhën shqipe jo vetëm këtu në Shqipëri, por kudo ku ajo flitet; kudo ku është gjuhë e komuniteteve shqiptare. Them që pas 30 vitesh (nëse jemi gjallë), do të jetë e qartë, pasi këto dialekte nuk do të ekzistojnë më, do të jenë zhdukur! Dhe të gjithë shqiptarët pas 30 vjetësh do të mundohen të

Kultura shqipe në zi, shuhet albanologu, Kumbaro: Na bëre gjëmën

flasin si tiranas. (Mungesa e dialekteve) është një varfërim, është një tmerr! Sepse gjuha e pasur shqipe me variante të ndryshme, me variante shumë të bukura, po zhduken, sigurisht që do të zhduken. Përpjekja ime për ta ruajtur atë që është sot”, thoshte ai në një intervistë për Anisa Ymerin mbi dokumentimin e këtyre dialekteve. Ai duket se e parandjeu ikjen e tij, por na la një shembull të mirë dhe një punë të çmuar, falas dhe online, për të gjithë.

“Megjithëse e kisha fotografuar në Tiranë, donte të fotografohej në një vend ku patën udhëtuar edhe studiues të tjerë të huaj. Shkuam tek Ura e Mesit dhe u vesh me kostumin e zonës. E donte shumë Shqipërinë”, shkruan fotografi Roland Tasho.

Më herët, partneri i tij i jetës, kish shkruar: “Sot, i shtrenjti im Bob, ra në gjumë përkrah meje,

përjetësisht. Së bashku, kemi mundur të ndajmë një jetë plot ngjarje që nisi në Rosenmontag më 1979”.

Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro shkroi se “sa ç'ishte e jashtëzakonshme puna e shkencëtarit albanolog Robert Elsie, akademik i lindur jo i titulluar, sa ç'ishte elegant dhe i papërsëritshëm arti i përkthimit të mjeshtrit Robert Elsie, sa ç'ishte delikat zëri i interpretit në kabinën e përkthimit, sa ç'ishte i madh ankthi i punës kur përjetonin dramën e gjyqeve të Hagës, sa ç'ishte i bukur çdo çast i gjurmimit dhe hulumtimit të detajeve shqiptare prej teje që krejt bujarisht i ndaje me të gjithë në shqiptarët e tjerë!” Ajo bëri me dije se është në kontakt me familjen e tij për të mësuar se cili ka qenë amaneti i tij.

Ngushëllime ka përcjellë edhe zvambasadori i OSBE-së, Robert Wilton, i cili shënonte se “shpre-

son që në fund të fundit të kuptohet se ai ka qenë dhe vazhdon të jetë një nga dy figurat më të mëdha në kulturën e shqiptarëve gjatë dekadave të fundit”. “Për mbrojtjen dhe për promovimin e trashëgimisë letrare shqiptare ai ka bërë një punë unike, vigane dhe të pazëvendësueshme”, - shtoi Wilton.

PROJEKTI I FUNDIT

Artur Metani, ka qenë një ndër miqtë e tij më të afërt në Shqipëri. Në çdo udhëtim anekënd Shqipërisë, Metani ishte me të. Është po ky mik e bashkudhëtar që i ka shkrepur foton e fundit këtyre anëve. Në të, Elsie, formon shqiponjën me duart e tij. “Një përpjekje për t'u bërë shqiptar! Foto në Korçë, marrë nga teqeja e Melçanit më 21 mars 2017”, shkruan ai mbi foto. Në një telefonatë me “GSH”, ende i prekur, Metani thotë se “Elsienë e kam njohur para 25 vitesh në Shqipëri”. E ka shoqëruar për herë të parë në mallet e veriut, në Tuz e Mal të Zi. “Kishte një ide për incizimin e dialekteve të gjuhës shqipe. Unë u bëra dragomani i tij”. Nuk veçon dot ndonjë takim, qoftë edhe nga tronditja.

“Ai kishte shumë takime. Udhëtimi i tij i fundit ishte në Shqipëri, ishte në jug te teqeja e

Miku i tij, Artur Metani: Projekti i fundit ishin teqetë e Shqipërisë

Melçanit. Me dy duart ai bën shqiponjën. Kishte në plan të vinte në pelegrinazhin e Baba Tomorit”. Nuk erdhi. Pas ikjes nga Shqipëria në mars, ai kish mësuar për sëmundjen e tij të rëndë. Në gusht ishte përkeqësuar se nuk mundi. “Kishte frikë se do lodhej. Nuk e përballonte dot. E kish mësuar sëmundjen e rëndë”, - thotë Metani. Projekti i tij i fundit për Shqipërinë, do u kushtohej teqeve. “Unë me të kishim në dorë një projekt për teqetë bektashiane. Me këtë po merreshim. Po bënim fotografi nga jugu në veri”, - thotë “dragomani” i tij, ndërkohë që vetë Elsie kishte postuar foto me Baba Mondin, kryegjyshin e komunitetit bektashian në Shqipëri, të dhëna për dervishët e Krutjës, e njëherësh edhe diçka mbi “rrëfimet e bektashinjve me dervish Abdyl Beqirin në teqenë e Harabatit në Tetovë”.

E pyes Metanin për amanetin e



Partneri i tij, Stefan Trierwiler: Ra në gjumë të përjetshëm përkrah meje

Albanologu, Robert Elsie



Robert Elsie me kostum kombëtar
Foto: Roland Tasho

tij. “Po. Kur ishte këtu, ai tha se donte të varrosej në Shqipëri. Këtë e di edhe partneri i tij, Stefani”.

IN MEMORIAM NGA BIBLIOTEKA

Një homazh Robert Elsie është bërë edhe nga Biblioteka Kombëtare, për kontributin e tij në pasurimin e fondeve të Bibliotekës Kombëtare. “Robert Elsie, krahas kontributit të tij të çmuar si albanolog, studiues e përkthyes, do të kujtohet me respekt dhe mirënjohje nga publiku shqiptar edhe për vetëdijen dhe kujdesin e veçantë që tregonte për pasurimin e arkivave të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë me dhurimet e veprave e artikujve të tij të shumtë studimorë”, thuhet në njoftimin për mediat. Sipas BK-së, ato përbëjnë sot një fond të vyer në fushën e albanologjisë dhe studimeve mbi letërsinë e kulturën mbarëshqiptare. Në fondet e Bibliotekës Kombëtare ruhen mbi 150 libra

Flutura Aça: Amaneti i Robert Elsie, të prehej në Shqipëri!

Ka qenë shkrimtarja Flutura Aça ajo që ka dhënë lajmin e ndarjes nga jeta të Elsie. Në një postim të orës tetë të mëngjesit të ditës së djeshme, ajo bashkë me lajmin e kobshëm bënte me dije edhe amanetin e tij, si më poshtë.

Zonja Mirela Kumbaro, Ministre e Kulturës,
Zoti Edi Rama, Kryeministri i Shqipërisë

Robert Elsie dëshironte të prehej në Shqipëri, bëjeni të mundur këtë! Dhe me të gjitha nderimet që meriton.

Miq! I kja sot e albanologut, studiuesit, përkthyesit, hulumtuesit, njeriut të të gjitha përmasave të letrave, njeriut që e dashuroi Shqipërinë si asnjë i huaj tjetër, Robert Elsie, është një nga humbjet më të mëdha për kulturën shqiptare. Një akademik që ecte, një nga njerëz-

it që punoi i vetëm aq sa institute nuk mundën dot, e la në mes e të pakryer këshilljellë letrare të tij ku strehonte kulturën shqiptare. Ai la pas një veprë të jashtëzakonshme dhe të pazvëndësueshme. Ne shqiptarët e sotëm mbase nuk do ta dimë mjaftueshëm kush është Robert Elsie, letrat shqipe sot mbase prej shkuajdesjes, nuk e kanë pasur vëmendjen e duhur ndaj këtij titani letrash, por brezat që do të vijnë, do ta kuptojnë që ky njeri i thjeshtë dhe jashtëzakonisht punëtor - një nga njerëzit më punëtorë të letrave që kam njohur - i ka bërë të tillë shërbim kulturës shqiptare, që ajo sot duhet të ndihet në zi. Kultura shqiptare është sot në zi. Vepra e këtij njeriu modest në natyrën e tij njerëzore, por e papërmasë si pasuri për ne, ka qenë engjëlli i vërtetë mbrojtës dhe i pazvëndësueshëm për kulturën shqiptare.



dhe artikuj shkencorë, kryesisht në fushën e albanologjisë, antropologjisë, përkthimeve nga thesaret e folklorit shqiptar, por edhe përkthime të autorëve të letrave shqipe, ku spikat kontributi i rëndësishëm përmes përkthimit të veprës epike të Gjergj Fishtës "Lahuta e Malcis". Tashmë Biblioteka Kombëtare, në homazh të këtij personaliteti të shquar, ka çelur një ekspozitë me kontributin e tij të jashtëzakonshëm. Gjithashtu, duke përcjellë këtu të dhëna mbi kontributin e tij shkencor, po tërheqim vëmendjen me respekt mbi ata tituj që ai i ka dhuruar personalisht për BKSH-në.

Njëhës i shkëlqyer shqipes dhe kulturës shqiptare, Robert Elsie ka përkthyer në gjuhën angleze autorë dhe poetë të rëndësishëm shqiptarë si Gjergj Fishta, Migjeni, Ali Podrimja, Fatos Kongoli, Azem Shkreli, Flora Brovina, Eqrem Basha, Ornella Vorpsi; është autor i shumë recencioneve mbi veprat e Ismail Kadarese, Xhevhahir Spahiu, Shqip Beqirri, Kasem Trebeshinës, etj.

SALI BERISHA

Dr. Robert Elsie mbyll sytë përgjithmonë!
Miq, një nderim të madh për Dr. Robert Elsie, burrin e shquar që shkriu jetën e tij për shqiptarët, gjuhën, letrat, historinë, identitetin dhe çështjen tonë! Mirënjohjen më të thellë për veprën e tij dhe ngushëllime të sinqerta familjes. I paharruar kujtimi yt, mik i madh dhe i dashur i kombit tonë.
Ngushëllime!

EDI RAMA

IN MEMORIAM

Robert Elsie, albanologu i shquar me origjinë nga Kanadaja, me veprimtarinë e tij të vyer 40 vitet e fundit bëri të njohur botërisht historinë, artin dhe kulturën e kombit shqiptar me një dashuri e pasion të pasqorë. Në trashëgiminë me vlera të jashtëzakonshme që na las, të spikasësh përkthimin e dorëshkrimit më të vjetër të historisë shqiptare nga prifti francez Jean-Claude Faveyrial; volumin UNESCO të Antologjisë Moderne të poezisë shqipe; Këngët e Kreshnikëve, veprat e Migjenit dhe Ali Podrimjes; apo kryeveprën "Lahuta e Malcisë" të Fishtës, është shumë pak... U prehsh në paqe, mik i mirë!

ROBERT ELSIE, NJË SHPIRT "ONLINE"

Luan Rama

E pashë "on-line": Robert Elsie ka vdekur! Dhe sa e pikasa këtë lajm, shkrova: "Na iku dhe një shqiptar i madh!" Një shqiptar?... Ju gabohe, zotëri! Robert Elsie nuk është shqiptar! Dhe unë menjëherë iu përgjigja atij zëri që nuk kuptoja nga më vinte: "Po, zotëri, Robert Elsie është shqiptar, si ti dhe si unë". Dhe menjëherë dola me një trisht në zemër. Eca nëpër Paris, në Parisin ku takoheshim më të sa herë vinte në Paris, pasi ai e donte shumë Parisin, edhe pse Shqipërinë e donte më shumë se gjithçka. Ishte ajo që e kishte mrekulluar, s'dihet si, s'dihet ku, ishte një lloj magjie që e kishte thithur të tërin dhe që jetës së tij i dha një drejtim krejt tjetër.

Një shqiptar i madh. Sigurisht, nuk gabohe, pasi prej dekadash ky intelektual i shquar do të jetonte me Shqipërinë, me historinë e shqipes, me historinë e letërsisë, me historinë dhe njerëzit, ata me zemër, ata që dinin ta bënin për vete. Vallë Shqipëria ishte një obsesion i tij? Jo, ishte një dashuri, një dashuri e madhe. Një nga ato dashuri ku hap krahë dhe harron për t'i mbyllur, krahë që duan të pushtojnë gjithçka.

Eca në Paris dhe përsëri Roberti. Ishim takuar në një kafene



Robert Elsie dhe Luan Rama

poshtë shtëpisë ku kishte vdekur Volter, kampioni i tolerancës njerëzore. Kishim bredhur nëpër Paris. Një vit tjetër kishim vizituar së bashku ekspozitën e Bujar Lucës në bulevardin "Haussmann". Kishim bredhur buzë Senës dhe kishim folur për ata albanologë që aq shumë i kishin dhënë Shqipërisë, për dorëshkrimet e vjetra dhe zbulimet e reja në lëmin e historisë dhe të dorëshkrimeve, pasi Robert Elsie ishte një eksplorator jo i maleve, as i lumenjve, por i historisë që kanë bërë njerëzit dhe kanë shkruar kronikanët. Më tregonte i lumtur për incizimet e tij në shqiptarët e Kosovës, veriut e jugut shqiptar, ndër shqiptarët e Greqisë. I lumturuar... më dërgonte me postë librat e tij, atë për historinë çame, për historinë e letërsisë, përkthimet e shumta letrare, albumet fotografike, gjithçka.

Nganjëherë me kërkonte ndonjë të dhënë për udhëtarët francezë

"on-line". Imazhe shqiptare dhe tekste të panumërta "on-line", një enciklopedi më vete "on-line" shkruar duke i paraprirë parakohës, duke shkuar shpejt përpara, sikur ta dinte se shumë pak kohë i kishte mbetur. Por gjithçka sot është "on-line". A ekziston një shpirt "on-line"? Mjafton të hyni në internet për të njohur nga pranë këtë personazh të jashtëzakonshëm të historisë e kulturës shqiptare. Ai e dinte se kontributi i tij do të shtonte diçka në punën e kolegëve të tij shqiptarë për shkrimin dhe rishikimin e historisë shqiptare. Shpirti i Robert Elsie ishte shkëputur prej kohësh nga ai trup, të cilit i pëlqenin aq shumë shakatë dhe barsolet shqiptare. Vallë e dinte që të thonë "faileminderit"? Nuk e besoj... Shpirti i tij tani ekziston gjetëk, duke u bërë i prekohshëm dhe i pranishëm në miliona shqiptarë dhe njerëz të botës që duan të njohin diçka nga historia, kultura dhe letërsia shqiptare.

Visar Zhiti: Robert Elsie, biri shpirtëror i Shqipërisë

Shuarja e albanologut më të madh në botë sot, Robert Elsie, është një humbje e madhe për kulturën shqiptare, për historinë dhe për vlerat shekullore të saj, për antropologjinë, gjuhën e përkthimin, për studimet letrare e letërsinë, për kritikën letrare, për fotografimin historike etj., etj. Robert Elsie është poliedrik, i shumëplanshëm, hulumtues pasionant, zbulues i rëndësishëm, me një Shqipëri ideale që e deshi shumë e i kushtoi jetën. Robert Elsie guxonte si një intelektual i lartë. Ai e mbrojtë Shqipërinë në botë, "Çështjen Shqiptare", dhe e bashkoi në veprën e tij me Kosovën dhe Camërinë, pa

u tërhequr nga kërcënimet ballkanike e mosmirënjohja dhe i dha zë Shqipërisë, të flasë anglishten e tij. Ai dukej sikur e deshi çdo shqiptar dhe bëri për ta, i mbështeti kudo, deri edhe në

Tribunalin e Hagës, botoi antologji shqiptare, folklor, poetë nga të gjitha trevat, tregime, romane, nga letërsia jonë e ndaluar e shkrimtarët e burgosur, studime, albume, guida etj., etj., deri dhe te botimi i "Lahutës së Malcisë" së Fishtës në anglisht, një kryepunë, duke arritur kështu, siç thotë dhe vetë, të përplotësonte epusin evropian. Kështu bëri dhe me Kanunin e lashtë të shqiptarëve, të Lek Dukagjinit.

Pelegrin i tempujve të Shqipërisë, shtegtar i maleve tona, adhures i bregdetit, qytetar i Tiranës, mik i mrekullueshëm me ne. Mungesën e tij të dhimbshme e mbush vepra e tij e madhe, sa enciklopedike, po aq dhe akademike e shkollë, rilindëse dhe moderne, e qëndrueshme dhe frymëzuese për vazhdimësi. Është nder që Shqipëria ta shpallë bir të vetin dhe ta mbajë si të tillë.

P prej ditës së sotme deri më 7 nëntor të këtij viti, fillojnë aplikimet për Lotarinë Amerikane për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të jetojnë në SHBA. Por këtë vit kandidatët duhet të kenë kujdes që të mos aplikojnë në ditët e fundit, pasi mund të shkaktojnë mbingarkesë në sistem. Ditën e djeshme, Emily Enright dhe Lorenc Mansaku kanë dhënë udhëzimet e fundit për të gjithë të interesuarit në mënyrë që të mos bëhen gabime, çka mund t'i skualifikojë. "Për të marrë pjesë ka dy kritere kryesore; ose duhet të kesh shkollën e mesme me kohë të plotë, ose eksperiencën e punës, por arsimi është kryesisht ai që i kualifikon shqiptarët. Ka një ndry-

Ambasada gjermane: Kërkojmë trajnues në arsimin profesional

Fillojnë aplikimet për Lotarinë Amerikane, Mansaku: Ja kriteret

POLITIKA

Ka vetëm një faqe ku mund të aplikoni: dvlotttery.state.gov.us. Gjuha angleze nuk është kriter për lotarinë, dhe as mosha gjithashtu. Çdokush ka të drejtë të aplikojë. Duhet të kenë parasysh gjithashtu që të aplikoni me statusin aktual; nëse jeni në proces divorci, ju duhet të përfshini bashkëshortin tuaj dhe fëmijët nëse keni"

shim këtë vit, që kur bëhet verifikimi i të dhënave do të keni mundësinë të shikoni foton. Këtë vit kjo është e mundur, dhe ne sugjerojmë që të shikoni me saktësi informacionin që keni hedhur

për të aplikuar. Ka vetëm një faqe ku mund të aplikoni: dvlotttery.state.gov.us. Gjuha angleze nuk është kriter për lotarinë, dhe as mosha gjithashtu. Çdokush ka të drejtë të aplikojë. Duhet të keni

parasysh gjithashtu që të aplikoni me statusin aktual; nëse jeni në proces divorci, ju duhet të përfshini bashkëshortin tuaj dhe fëmijët nëse keni", - tha Mansaku në emisionin "Rudina" në "TV Klan".

AMBASADA GJERMANE

Ndërkaq, Ambasada Gjermane ka shprehur interesin për trajnues në arsimin profesional, në mënyrë që t'u mundësojë shumë të rinjve formim profesional. "Kërko-



Ambasada amerikane në Tiranë

hen: trajnues në arsimin profesional, të cilët me anë të ndihmës gjermane do t'u mundësojnë më shumë të rinjve një formim dhe trajnim profesional", thuhet në njoftimin e ambasadës. Ky trajnim do të ofrohet për një

periudhë 3-6 muaj për rreth 50-150 pjesëmarrës, e ka në fokus të rinjtë e moshës 19-34 vjeç. Në trajnim 40% e pjesëmarrësve janë femra dhe 30% e të trajnuarve janë migrantë të rinj që kthehen nga vendet e BE-së.

Vetëm dy mjekë e dy dhoma vizitash për këtë pavijon, prindërit të revoltuar

Voltiza Duro

R adhët e gjata në Urgjencën e Pediatricë në QSUT, janë kthyer në një makth për shumë prindër që presin me fëmijët e sëmurë në duar. Ditën e djeshme, dyndja e pacientëve nuk ka mundur të përballohet vetëm nga dy dhoma vizitash që ka në dispozicion ky pavijon. Prindërit shprehën tepër të shqetësuar mbi situatën e krijuar. "Kam 3 orë që pres në radhë, vajza ime vetëm 3 vjeçe ka temperaturë të lartë e asnjë nuk po e merr për sipër. Kemi frikë të sjellim fëmijët në spital sepse rrimë në korridor e shërbim nuk marrim. Nuk kam mundësi ekonomike, sepse do e dërgoja në privat pa e menduar dy herë", - shprehet duke qarë një nënë, e cila mban në prehër vogëlushen e sëmurë. Por, radhët e gjata sipas prindërve janë një problem i hershëm në Urgjencën Pediatricë të QSUT-së, çka shpeshherë krijon mbingarkesë, pakënaqësi, por edhe polemika mes vetë pacientëve, që debatojnë për radhën me njëri-tjetrin. "Djali im është i bllokuar, kam 3 ditë që e sjell këtu e pres mbi 2 orë në radhë. Vetëm dy mjekë janë këtu, nuk e përballojnë dot, kështu që përgjegjësit të marrin masat e të sjellin më shumë doktorë, që të na vizitojnë fëmijët", - thotë për "GSH" një tjetër prind. Por, burime nga shërbimi i Urgjencës Pediatricë në QSUT, thonë se qytetarët nuk e zbatojnë sistemin e referimit, pra të shkojnë paraprakisht në poliklinikat e lagjeve. "Struktura përcakton vetëm dy mjekë të miratuar nga QSUT, por prindërit nuk i dërgojnë në pediatri dhe lagjeve ku banojnë, por i sjellin direkt këtu, në një kohë që të gjitha lagjet pa përjashtim kanë pediater deri në orën 20:00. Nuk duhet të ndodhë diçka e tillë, Urgjencia është vetëm për rastet që

Dyndje e radhë të gjata në Urgjencën Pediatricë

QSUT: Të zbatohet sistemi i referimit



Radhët e gjata dhe në Urgjencën Pediatricë



QSUT

2 MJEKË

"Qytetarët nuk e zbatojnë sistemin e referimit, pra të shkojnë paraprakisht në poliklinikat e lagjeve. Struktura përcakton vetëm dy mjekë të miratuar për Urgjencën Pediatricë në QSUT", - bëjnë me dije burime nga shërbimi i Urgjencës Pediatricë në QSUT.

Prindërit

KËRKESA

"Djali im është i bllokuar, kam 3 ditë që e sjell këtu e pres mbi 2 orë në radhë. Vetëm dy mjekë janë këtu, nuk e përballojnë dot, kështu që përgjegjësit të marrin masat e të sjellin më shumë doktorë, që të na vizitojnë fëmijët", - thotë një nga prindërit.

rekomandohen nga mjeku i lagjes dhe që përbëjnë raste urgjente, por të gjithë zgjedhin të dynden në dyert e QSUT-së. Janë vetë prindërit që e shkaktojnë këtë radhë", - shprehen për "Gazeta Shqiptare" burime nga shërbimi i Urgjencës Pediatricë. Pra, sipas QSUT-së, pavarësisht thirrjeve të vazhdueshme ndaj prindërve për t'u drejtuar te pediatri i lagjes, sërish anashkalohet ky proces, duke krijuar dyndje të panevojshme edhe për vizitat e thjeshta. Por, shumë prej prindërve shprehën se vijnë me rekomandim nga mjeku i lagjes, e për të tjerë rasti i fëmijës së tyre konsid-

erohet si urgjent, e përpos kësaj, disa prej tyre kanë më shumë besim në aftësitë e mjekëve të QSUT-së, sesa te pediatri e lagjeve. Ndërkohë, radhët e gjata fillojnë të dera e jashtme e Urgjencës, deri në dhomën e vizitave, turmat e prindërve presin me fëmijë të sëmurë në krahë, shumica e tyre në këmbë, pasi numri i stolave nuk është i mjaftueshëm për të gjithë. Deri në arrijeten e një "konsensusi" mes kërkesave të prindërve dhe zbatimit të sistemit të referimit, fëmijët e sëmurë duhet të enden dyerve të spitalëve me orë të tëra, për të bërë vizitën e për të marrë një zgjidhje.

SHKURT

Karta e shëndetit, aplikimi 'online'

Aplikimi për kartë shëndeti mund të bëhet 'online' përmes portalit 'e-Albania' nga kryefamiljari, si për të rriturit, ashtu edhe për fëmijët e moshës 0-18 vjeç. Pasi të jetë bërë regjistrimi te mjeku i familjes, vetëm me një dokument identifikimi, qytetari mund të vijojë më tej me procedurat. "Karta e shëndetit është dokumenti që vërteton se mbajtësi i saj është person i siguruar dhe përfiton shërbimet shëndetësore pa pagesë. Karta është personale, e patjetrueshme dhe shpërndahet pa asnjë pagesë apo tarifë shërbimi", thuhet në njoftimin e "e-Albania". Ky shërbim ofrohet menjëherë 'online' për kategoritë: punësuar, i vetëpunësuar, invalid i plotë, invalid lufte, invalid i pjeshëm, veteran, pensionist etj.

Monitorim nga INFOCIP, Tirana çnim për transparencën

Në bazë të monitorimit të kryer në 61 bashkitë e Republikës së Shqipërisë nga INFOCIP, të vlerësuar më mirë rezultojnë Bashkia e Korçës, Tiranës e Shkodrës. Qendra për Çështjet e Informimit Publik ka bërë shqyrtimin e situatës për vitin 2017 si dhe ka krahasuar treguesit me gjetjet e 2016-ës. Sipas raportit të publikuar, viti 2017 ka shënuar progres në masën 71% krahasuar me vetëm 31% në vitin 2016. Tirana u vlerësua si një nga bashkitë më transparente me qytetarët. Erion Veliaj, gjatë tërheqjes së çmimit të transparencës tha se situata për Bashkinë e Tiranës ka ndryshuar pozitivisht.

SHBA
MASAKRA



Pamje nga sulmi terrorist në Las Vegas



Masakër në shtetin e kazinove gjatë një koncerti, policia ekzekuton autorin 64-vjeçar

Egla Xhemali

Sulm terrorist në Las Vegas, 50 të vrarë, mbi 200 të plagosur

ISIS merr përsipër ngjarjen e rëndë, ja kush ishte autori

Shtetet e Bashkuara të Amerikës po vuajnë vrasjen masive më të madhe në histori, pasi të paktën 50 vetë u vranë dhe më shumë se 200 u plagosën në një koncert të muzikës 'country' në Las Vegas të dielën në mbrëmje. Të shtënat nisën afër fundit të festivalit në "Route 91", ku ishin të pranishëm 22 mijë vetë, përfshirë këtu edhe performuesit e njohur Eric Church, Sam Hunt dhe Jason Aldean. Sulmi me armë ka tronditur Las Vegasin rreth orës 22:30 në zonën e "Mandalay Bay" ku dhe mbahej koncerti. Raportohet nga policia se numri i të vdekurve ka arritur shifrën 50 dhe mbi 200 persona kanë mbetur të plagosur. Në fillim janë dëgjuar të shtëna me armë, pastaj heshtje mbi turmën e njerëzve e minuta më vonë janë dëgjuar të bërtiturat e tyre dhe lëvizje të vrullshme. Këto janë momentet e para pas sulmit në koncertin 'country' në Las Vegas. Një person qëlloi me armë mbi turmën nga kati i 32-të i një pallati. Dhjetëra persona sapo dëgjuan të shtënat vrapuan për t'u fshehur e të tjerë ngelën në territorin ku u shënuar ngjarja. Personi i armatosur, i cili është identifikuar si Stephen Paddock, banor i Nevadas, hapi zjarr me armë tip mitraloz në drejtim të turmës që po ndiqte koncertin, duke shkaktuar viktima dhe të plagosur përpara se të ekzekutohej nga policia. Policia ka raportuar duke thënë se sulmi me armë në koncertin që zhvillohej në Mandalay Bay Las Vegas është vepër e një "ujku të vetmuar", që do të thotë individ i frymëzuar nga ideologjia ekstremiste, por që nuk ka lidhje të drejtpërdrejta me grupe të njohura terroriste. "Në këtë pikë në përjashtojmë se ngjarja ka të bëjë me një akt terrorist, edhe pse nuk dihet ende pse ky person ka hapur zjarr në koncert, duke vrarë 50 persona dhe plagosur mbi 200 të tjerë", - ka thënë policia e Las Vegasit. Gjithashtu,



Autori i sulmit makabër që ndodhi në Las Vegas, Stephen Paddock

DEKLARATË
"Konfirmojmë se Stephen Paddock, 64 vjeç, i dyshuar për ngjarjen e tmerrshme është qëlluar për vdekje. Një hetim aktiv është duke u zhvilluar, ndërsa lutemi që njerëzit të shmangin këtë zonë", shkroi në "Twitter" Departamenti i Policisë së Las Vegasit.



SULMI
Sulmi me armë në koncertin që zhvillohej në Mandalay Bay, Las Vegas është vepër e një "ujku të vetmuar", që do të thotë individ të frymëzuar nga ideologjia ekstremiste, por që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta me grupe të njohura terroriste.



policia konfirmoi se person i dyshuar është qëlluar: "Konfirmojmë se Stephen Paddock, 64 vjeç, i dyshuar për ngjarjen e tmerrshme është qëlluar për vdekje. Një hetim aktiv është duke u zhvilluar, ndërsa lutemi që njerëzit të

shmangin këtë zonë", shkroi në "Twitter" Departamenti i Policisë së Las Vegasit raport "Tg.com". Policia është në ndjekje të një gruaje aziatike, Mary Lou Danley, 62 vjeçe, e cila sipas tyre ka lidhje me agresorin, madje ata jetonin

në të njëjtën shtëpi. Gjithashtu, blutë janë ndjekje të dy makinave, një "Hyunday" dhe një "Chrysler Pacific", që janë në pronësi të autorit të ngjarjes. Ndërkohë, në një deklaratë të publikuar nga media propagandistike e ISIS,

50

TË VDEKUR

Policia raporton se numri i të vdekurve ka arritur shifrën 50 dhe mbi 200 persona ka ngelur të plagosur në koncertin e së dielës, që u mbajt në zonën e "Mandalay Bay" në Las Vegas. Të dhënat që vijnë nga autoritet bëjnë me dije se numri i të lënduarve në gjendje të rëndë vazhdon të rritet.

64

-VJEÇARI

Autori i sulmit makabër që ndodhi në Las Vegas, Stephen Paddock kishte lëvizur shuma të konsiderueshme parash në llogaritë që kishte në disa sallone lojërash fati në Las Vegas dhe thonë se po punohet për të gjetur nëse bëhej fjalë për para të fituara nga bixhozi, apo borxhe për të shlyer.

'Amaq', agjencia lajmërore se agresori ishte "luftëtar i Shtetit Islamik". Lajmi është bërë i ditur nga media angleze "Independent", edhe pse autoritetet amerikane nuk e kanë hetuar si rast terrorist sulmin e djeshëm. Reagimet për ngjarjen kanë qenë të shumta. Eric Paddock, vëllai i autorit të masakrës së Las Vegasit, ku deri më tani autoritetet kanë konfirmuar vdekjen e 50 personave foli në një intervistë të shkurtër për mediat amerikane. "Akoma nuk e kuptoj se çfarë ka ndodhur. U shpreh ngushëllime familjarëve të viktimave! Ne nuk kishim vënë re asnjë ndryshim tek Stephen kohët e fundit. Ai ishte i qetë dhe armët nuk i ka pasur

kurrë për zemër", thot Eric. Megjithatë, familja Paddock ka pasur probleme me ligjin edhe në të shkuarën. Babai i Stephen, Benjamin Hoskins Paddock qëndroi për tetë vite në arrati në listën e më të kërkuarve të FBI-së pas arratisjes nga burgu, ku ishte dënua për një seri grabitjesh të bankave dhe më pas ishte diagnostikuar si i sëmurë mendor. Ndërkohë, autoritetet amerikane konfirmuan se Stephen kishte lëvizur shuma të konsiderueshme parash në llogaritë që kishte në disa sallone lojërash fati në Las Vegas dhe thonë se po punohet për të gjetur nëse bëhej fjalë për para të fituara nga bixhozi, apo borxhe për të shlyer.

Table with 5 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Programi Studimi, ID MATURANTI, Rezultati. Rows 1-48.

Table with 5 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Programi Studimi, ID MATURANTI, Rezultati. Rows 49-96.

Table with 5 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Programi Studimi, ID MATURANTI, Rezultati. Rows 97-144.

Table with 5 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Programi Studimi, ID MATURANTI, Rezultati. Rows 145-292.

Table with 5 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Programi Studimi, ID MATURANTI, Rezultati. Rows 293-440.

Table with 5 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Programi Studimi, ID MATURANTI, Rezultati. Rows 441-588.

Table with 5 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Programi Studimi, ID MATURANTI, Rezultati. Rows 589-736.

Table with 5 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Programi Studimi, ID MATURANTI, Rezultati. Rows 737-884.

Table with 5 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Programi Studimi, ID MATURANTI, Rezultati. Rows 885-1032.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Pradhim bimor, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 29-48.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Zootekni dhe bimës blegjtore, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 49-68.

Table with 5 columns: No, FAKULTETI, Kodi, Programi Studimi, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 1-20.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Pradhim bimor, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 49-68.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Zootekni dhe bimës blegjtore, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 69-88.

Table with 5 columns: No, FAKULTETI, Kodi, Programi Studimi, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 21-40.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Pradhim bimor, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 69-88.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Zootekni dhe bimës blegjtore, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 89-108.

Table with 5 columns: No, FAKULTETI, Kodi, Programi Studimi, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 41-60.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Pradhim bimor, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 89-108.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Zootekni dhe bimës blegjtore, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 109-128.

Table with 5 columns: No, FAKULTETI, Kodi, Programi Studimi, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 61-80.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Pradhim bimor, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 109-128.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Zootekni dhe bimës blegjtore, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 129-148.

Table with 5 columns: No, FAKULTETI, Kodi, Programi Studimi, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 81-100.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Pradhim bimor, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 129-148.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Zootekni dhe bimës blegjtore, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 149-168.

Table with 5 columns: No, FAKULTETI, Kodi, Programi Studimi, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 101-120.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Pradhim bimor, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 149-168.

Table with 5 columns: No, BUQËSË DHE I MËDITË, S, Zootekni dhe bimës blegjtore, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 169-188.

Table with 5 columns: No, FAKULTETI, Kodi, Programi Studimi, ID MATURANIT, Rezultati. Rows 121-140.

Table with 6 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Program Studi, ID MATURANT, Rezultati. Rows 1-49, containing data for various faculties and programs.

Table with 6 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Program Studi, ID MATURANT, Rezultati. Rows 50-99, continuing the list of faculties and programs.

Table with 6 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Program Studi, ID MATURANT, Rezultati. Rows 1-49, containing data for various faculties and programs.

Table with 6 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Program Studi, ID MATURANT, Rezultati. Rows 50-99, continuing the list of faculties and programs.

Table with 6 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Program Studi, ID MATURANT, Rezultati. Rows 1-49, containing data for various faculties and programs.

Table with 6 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Program Studi, ID MATURANT, Rezultati. Rows 50-99, continuing the list of faculties and programs.

Table with 6 columns: Nr, Fakulteti, Kod, Program Studi, ID MATURANT, Rezultati. Rows 1-49, containing data for various faculties and programs.

Opinion i Ditës

Ribashkimi dhe mençuria politike gjermane

Nga Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... me hapat, vendimet dhe vepërimet e shumta strategjike që çuan drejt këtij akti të shënuar për gjithë Evropën.

Krahas mbështetjes së fuqishme ndërkombëtare sidomos nga ana e SHBA-ve, ribashkimi i Gjermanisë ishte, pa dyshim, fryt i vizionit dhe pragmatizmit të spikatur politik të liderëve të tij - burra shteti të mëdhenj të periudhës së Pasluftës II Botërore - Adenauer, Erhaus, Brandt, Schmit dhe Kohl; kjo traditë ka vijuar dhe tej ribashkimit nga kancelarët e mëvonshëm Gerhard Schroder dhe gjatë 12 viteve të fundit nga Angela Merkel.

Në këtë shkrim do të ndalemi në një temë pak të prekur - mençurinë e rrallë politike gjermane për të "kopjuar" dhe zbatuar pa asnjë paragjykim strategji dhe programe të paraardhësve kundërshtarë, madje të ashpër politikë; liderët emblematikë gjermanë e bënë këtë me guxim dhe kurajë unike, duke iu kundërvënë në jo pak raste dhe një pjese të madhe të elektoratit, edhe pse kësaj ata vunë në pikëpyetje, madje humbën dhe të ardhmen e tyre politike. Ja disa prej rasteve më pikante.

Me fillimin e viteve '50, kancelari historik gjerman Konrad Adenauer i tha menjëherë dhe me plot gojë "Po" thirrjes dhe ftesës së Shumanit për krijimin e BE-së dhe Gjermania u bë një ndër 6 themelueset e saj të para. Por, social-demokratët e SPD-së nuk e mbështesin një nismë të tillë. Jo se ishin kundër BE-së, porse donin që fillimisht të ribashkohej Gjermania që ajo të hynte e bashkuar në BE. Social-demokratët gjermanë mendonin gabimisht se ribashkimi gjerman ishte çështje e pak viteve.

Mirëpo ngritja e Murit të Berlinit më 1961-shin më në fund i bindi edhe ata se ribashkimi do të kërkonte dekada të tëra. Ndaj, pas ardhjes në pushtet më 1969-ën nuk e ngadalësuan e as e ndalën, por e intensifikuan më tej procesin e integritetit dhe zgjerimit evropian të filluar nga e djathta gjermane.

Nga ana tjetër, SPD-ja e kishte kuptuar më shpejt se e djathta gjermane se Muri i Berlinit dhe regjimet totalitare në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore nuk mund të ndryshonin më me forcën e armëve dhe të ndërhyrjeve ushtarake, por vetëm në mënyrë paqësore.

Ndaj, më 1970-ën, Kancelari Brandt laçoi pa vonesë të mirënjohurën "Ostpolitik" ose "ndryshim nëpërmjet afrimit". Praktikisht, Ostpolitika synonte që me programe, projekte dhe marrëveshje në të gjitha fushat, përfshirë edhe ato të arsimit, kulturës dhe kontakteve njerëzore, të shmangeshin efektet e mureve ndarëse dhe izoluese, duke u zëvendësuar me ura bashkuese, sepse kështu do të njiheshin më mirë realitetet në vendet përkatëse, me qëllim që, kur të vinte momenti, ndryshimet të pranoheshin pa dhunë dhe pa gjak. Ostpolitika nisi duke shfuqizuar doktrinën e deri



atëherëshme "Hallstein" të Adenauerit dhe që mbështetej në ndryshimin e regjimit në RDGJ me dhunë dhe forcën e armëve.

Por, këtë radhë ishte CDU-ja që nuk po e kuptonte realitetin. Ndaj ajo e sulmoi hapur dhe ashpër Ostpolitikën. Kancelari Willy Brandt u etiketua në masë "tradhtar", u organizuan protesta masive e kështu me radhë. Por, pasi u laurua me çmimin "Nobel" për paqe për Ostpolitikën dhe kur ish-BS po tregonte qartë se nuk do të hiqte dorë nga përdorimi i forcës për të mbrojtur vendet e saj satelite, edhe CDU-ja e kuptoi dobënë e kësaj strategjie paqësore evolucionare. Ndaj, Kancelari Helmut Kohl e vijoi zbatimin me konsekuencë Ostpolitikën deri më 1989-ën, që kulmoi me shembjen e Murit të Berlinit.

Nga fundi i viteve '70, ish-BS kishte filluar montimin e raketave

bërthamore me rreze të mesme veprimi "SS 20". Në këtë kohë, ish-Kancelari Helmut Schmidt, me guxim vendosi të mbështesë doktrinën e NATO-s ose "vendimin e dyfishtë" të vitit 1979. Ai këmbënguli që në rast se Rusia do të vijonte atë kurs, atëherë edhe në Gjermani të vendoseshin raketat amerikane. Kjo hasi në rezistencën masive të lëvizjes paqësore në Gjermani dhe në demonstrime të përditshme të qindra mijëra njerëzve përpara zyrës së Schmidt, i cili i qëndroi deri në fund besnik këtij projekti. Mirëpo ky vendim ndikoi ndjeshëm në dobësimin e pozitave të qeverisë dhe në tetor 1982, koalicioni qeveritar me liberalët që ai kryesonte humbi votësimin parlamentar.

Schmidt u largua nga politika aktive me dinjitetin që koha dhe publiku e vlerësoi gjërësisht. Edhe 30 vjet pas largimit, në daljet e tij

të shpeshta e të mirëpritura publike dhe televizive, ai sërish e konsideroi të drejtë dhe të nevojshëm një vendim të tillë. Po kështu dhe pasardhësi i tij, Helmut Kohl, ky euroatlantist legjendar e zbatoi me mençuri vendimin e dyfishtë, duke deklaruar me guxim politik se Gjermania ishte partnere serioze dhe nuk mund të dilte kundër partnerëve transatlantike.

Po në vitet '80, Partia e të Gjelbërve sidomos në Gjermani dhe në disa vende të tjera të Evropës ish-in fuqizuar mjaft. Suksesi i tyre konsistonte në politikën pacifiste kundër çdo lufte dhe konfrontimi të armatosur dhe në mbrojtjen e mjedisit. Mirëpo, me ardhjen e tyre në qeverinë e koalicionit me social-demokratët në vitin 1998, të Gjelbërit u përballën me qëndrimin politik lidhur me konfliktin e dhunshëm në Kosovë. Lideri i tyre karizmatik, Joschka Fischer, që ishte zv.kancelar dhe ministër i Jashtëm, e mbështeti pa rezervë ndërhyrjen e armatosur të NATO-s ndaj Serbisë së Millosheviçit. Për pasojë, të Gjelbërit dhe lidhësit e tyre patën shumë kritika dhe goditje politike, madje dhe fizike në selinë e Parlamentit Evropian për "tradhti të lartë" etj. Por, Fisher nuk u tërhoq nga ai kurs, duke deklaruar qartë se ata ishin në favor të ndërhyrjes ushtarake në Kosovë, si mjeti i vetëm dhe i fundit për shmangien e gjakderdhjes dhe vendosjen e paqes.

Në vitin 2002, Kancelari Gerhard Schroder rifitoi mandatin e dytë. Por, ai kishte konstatuar edhe më parë se gjendja ekonomike e vendit ishte në rënie. Papunësia po rritej

me shifra alarmante dhe në vitin 2004 kapi shifrën rekord prej 5 milionë vetësh!

Schroder mund të vijonte punën pa ndonjë lëvizje madhore politike e ndoshta të fittonte dhe një mandat të tretë, duke ia hedhur fajin paraardhësit të tij; në të kundërt, do të ndeshje me pakënaqësi popullore me pasoja për të. Por, ai ishte i ndërgjegjshëm se kryecilësia e një shtetari të vërtetë është përgjegjësia para vendit të vet dhe jo e ardhmja e tij politike. Shkurt, duhej ndërmarrë sa më shpejt të ishte e mundur një reformë themelore ekonomike dhe financiare që të shtonte fuqinë konkurruese gjermane dhe të përmirësonte nivelin social dhe ekonomik të popullsisë. Nuk vonoi dhe Schroder laçoi këtë reformë madhore "Agenda 2010", por hasi në kundërshtimin masiv nga njerëzit, duke filluar nga radhët e partisë së tij social-demokrate. Megjithatë, ai iu përmbajt vendimit të tij, duke e çuar vendin në zgjedhjet e parakohshme në shtator 2005, me qëllim që të rifitonte besimin e shumicës për një reformë të tillë jetike. Si një makinë e rrallë elektorale, mjeshtër dhe magnet i medias, karizmatik dhe orator i lindur, falë fushatës së tij tejet aktive në të gjitha frontet, ai arriti ta ngushtonte madje ndjeshëm diferencën prej gati 20 pikësh ndjeshëm. Humbi vetëm për tri vende në parlament, duke e lënë gjithsesi SPD-në në bashkëqeverisje me Merkel.

Dhe ai u largua nga skena politike me dinjitetin e duhur, duke lënë pas një reformë që koha dhe ngjarjet e mëvonshme e dëshmoi si tejet të nevojshme dhe të dobishme. Ndërsa Kancelaria Merkel jo vetëm nuk e hodhi poshtë, por e zbatoi "Agenda 2010" me fanatizëm, duke bërë natyrisht disa ndryshime të lehta për të qenë sa më bindës për elektoratin.

Është pranuar gjërësisht se Gjermania i mbijetoi dhe lulëzoi me gjithë krizat e rënda e të gjithanshme që pushtuan Evropën dhe botën vitet e fundit kryesisht falë "Agenda 2010".

Së fundi, ia vlen të nënvizohet se këto përvoja dhe praktika të çmuara nuk kanë thjesht vlera historike e ca më pak të jenë "arkivuar". Përkundrazi, ato janë ngulitur thellë në ndërgjegjen dhe axhendën e politikës së sotme gjermane. Me siguri ato do të shfaqen tani e në të ardhmen, përballë sfidave të reja madhore me të cilat po ndeshet ky vend i shquar mbi të gjitha për mençurinë politike dhe mrekullinë ekonomike.

Mësimi që del nga këto praktika dhe përvoja madhore është se në vendet e konsoliduara demokratike, të parat vijnë politikë, alternativat, e pastaj politikanët dhe e ardhmja e tyre. Edhe në rastet kur puna nuk ecën, janë këta të fundit që bëhen "kurban". Por, natyrisht, koha si gjykatësi më i mirë dhe elektorati më vonë i ndikon dhe më shumë këta politikanë dhe shtetërit të mëdhenj, siç veprom dhe Gjermania moderne.

Opinion *i* Ditës

Personelizimi si rënie e demokracisë!

Nga Arian Galdini

(vijon nga faqja 1)

... gëlojnë një shumësi gjërash të bukura.

Personale më së pari kumton se, për çfarëdo çështje, mendim, send, problem, gëzim, arsye, motiv, vepër etj. të jem duke folur, më përket mua.

Kjo përkatësi më jep mua dhe vetëm mua të drejtat dhe përgjegjësitë gjithçka e përkufizoj si personale.

Për t'i rënë shkurt e për ta ruajtur shtjellimin mbi këtë argument në një moment të dytë, po vij të: përse kjo nisje?

Sepse regjimet, autokracitë, diktaturat, tiranitë, këtu e kanë thelbin dhe fuqinë: të shtetëzimi i personales.

Shtetëzimi i personales në diktaturë, na kthen në objekte dhe subjekte të pushtetit.

Personalja bëhet shkak armiqësie ose edhe drejtpërdrejt armike e pushtetit. Kush përkufizon diçka tjetër veç partisë si përkatësi, bëhet telash e pëson telash. Shtetëzimi i personales, bën që ne të mos kemi asnjë të drejtë përkatësie, vendimi a zgjedhjeje. Pushteti mendon e merr vendime për ne.

Pra, në dhjetorin '90, kur studentët dhe qytetarët shqiptarë ngritën krye e u ngritën në këmbë me thirrjen "E duam Shqipërinë si gjithë Europa", ndoshta e dinin, ndoshta jo, por kryen aktin e parë personal duke rrefyer publikisht se çfarë duan.

Personalja e shtetëzuar, nuk është publike, sepse nuk krijon bashkësi, por masa.

Personalja në liri, kur bëhet publike, nuk shkrihet, nuk asgjësohet, por krijon komunitet. Në këto 27 vite kemi luftuar kaq shumë për personalen, sa shpesh kemi tejkaluar kufijtë.

Nga grykësia, lakmia e padija, bënim personale edhe çfarë nuk na përkiste, ose shkatërronim si shtetërore edhe atë çka ishte publike. Ja ku jemi sot, në një situatë aspak tiranike dhe aspak diktatoriale.



Sidoqoftë, sjelljet dhe simptomat e pushteteve janë tërësisht autokratike dhe armike të lirisë.

Teza ime është e thjeshtë. Këta duan shumë të rivendosin diktaturë, por realiteti gjeostrategjik dhe fuqia e personales së çliruar në Shqipëri, nuk ua mundëson. Ndaj edhe bëjnë çdo ligësi dhe marifet për depersonalizimin e qytetarit shqiptar.

Duan ta shtetëzojnë fare personalen, por nuk munden, ngase nuk mund të vendosin dot asnjë formë diktature.

Mbi këtë logjikë, përdërisa nuk e kanë të mundur krijimin e shtetit totalitar, bëjnë tregtarizimin e shtetit.

Tregtarizimi i shtetit, nuk na e shtetëzon personalen, por na e bën.

Blerja e personales na kthen, nga persona me personalitet, d.m.th. nga qytetarë me dinjitet, në personel.

Blerja e personales bëhet me shitblerjen e votës, shërbimeve publike, ofiqeve, vendit të punës, karrierës, mandatit të deputetit etj., etj.

Si rrjedhim, në parti nuk jemi më as militantë e as kontributorë, por thjesht personel.

Si kanë ardhur kohët, partitë nuk kanë më nevojë fare as për idealistë, as për mendimtarë, as për militantë, as për kontributorë, as

për traditë e as për risi. Partitë duan vetëm personel.

Lideri i partisë është shitblerësi më i madh i personales sonë. Kështu që, politikë më pa para nuk bën dot askush. Politika nuk është me zgjedhje, konkurrencë, liri. Politika është bërë vepërtari tregtar. Dinjiteti njerëzor është shpallur si barrierë e politikës si vepërtari tregtar dhe po luftohet pa mëshirë nga të gjitha partitë.

Deri para pak kohësh unë kam shkruar për qytetarin e dobët. Sot nuk jemi më as qytetarë të dobët. Jemi më keq akoma. Na konsiderojnë thjesht personel.

Kjo shënon edhe rënien e demokracisë...

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

HOROSKOPI

DASHI

Merrni vendimet duke ruajtur ekuilibrin dhe duke shmangur reagimet gjaknxehta. Duhet patjetër të tregoheni të kujdesshëm. Nëse do t'ia lejonit, një familjar do të jetë i lumtur t'ju ndihmojë. Mos lini që kjo mundësi t'ju ikë. Përfiltoni.

DEMI

Dashuria do t'ju godasë në mënyrë të parëzistueshme, thellësisht, ndoshta edhe pak në mënyrë të mistershme, por e sigurt që do të jetë një përvojë e këndshme. Në punë bëni bilancin dhe verifikoni nëse jeni duke bërë atë që doni. Kërkoni gjithmonë të ndiheni mirë.

BINJAKET

Gjithçka do të shkojë për më mirë, mbi të gjitha nëse kërkoni të veproni në aktivitetin tuaj, gjithmonë duke u bazuar në kritere të pashmërisë dhe respektit për të tjerët. Venusi do të jetë pak dinak ndaj jush, dhe sot do të keni si situata pozitive ashtu edhe kokëçarje të vogla.

GAFORJA

Bashkëveprimi i Plutonit, Uranit dhe Venusit ju favorizon që të rinovoni disa gjëra në fushën e dashurisë, për të vendosur më shumë mirëkuptim me partnerin. Hëna mike ju shtyn të ndërtoni, por mbajni sytë hapur kur vjen puna për bazën materiale.

LUANI

Me pozitivitetin e tyre, Dielli dhe Hëna ju mbështesin për të pasur një ditë të mbarë. Do të dini të përballemi me qetësi me çdo rrethanë. Dita e sotme do të karakterizohet nga entuziazmi, falë edhe perspektivave të mira që parashikohen.

VIRGJERESHA

Po jetoni një histori të bukur dashurie, ndaj bëni kujdes për të mos e ndërlikuar çka është e thjeshtë. Kush është beqar, ka mundësi të shkëlqyera për një takim të këndshëm. Organizoni një shëtitje në natyrë për të medituar mbi zgjedhjet tuaja më të fundit.

PESHORJA

Ditën e sotme, me ogurin e mirë nga bashkëveprimi i Uranit, Saturnit, Jupiterit dhe Plutonit, do të përjetoni gjëra pozitive në fushën e dashurisë. Keni nevojë të ndryshoni, të bëni gjëra të reja, të sillni ndryshime të frytshme në jetën tuaj.

AKREPI

Mësoni të vëzhgoni dhe do të zbuloni se jeta çdo ditë mund t'ju dhurojë ato gjërat e vogla të bukura që mund të bëjnë të lumtur cilindo prej nesh. Bëni kujdes nga lodhja nervore, pasi jeni shumë të ndjeshëm ndaj gjendjes emocionale të atyre që ju rrethojnë.

SHIGJETARI

Me mbështetjen që keni nga Urani, nuk duhet të ngadalësoni ritmin për të realizuar një projekt me sukses. Ndoshta do t'ju duhet një kohë e gjatë, por kjo nuk përbën problem. Në jetën në çift, Jupiteri do t'ju ndihmojë të stabilizoheni dhe të ndërmerri rrugën e qëndrueshmërisë.

BRICJAPI

Për shkak të planetëve që janë shumë tekanjorë ndaj jush, nganjëherë, kush ju qëndron pranë mund t'ju duket se ju kundërshton. Kërkoni një bisedë sqaruese. Ndërkaq, duke qenë nën ndikimin e theksuar të Uranit, mos e merrni çdo gjë për të mirëqenë.

UJORI

Bashkëveprimi i Marsit me Venusin ju dhuron energji për t'ju përkushtuar angazhimeve të përditshme. Ndërsa Saturni ju mbështet me ide gjënale për të lëvizur gjithçka. Do t'ia dini të nisni një projekt që po e mendoni prej shumë kohësh: rezultatet nuk do të vonojnë.

PESHQIT

Me Plutonin që ju mbështet, thellohuni në gjërat që ju përshtaten dhe ju interesojnë më shumë, dhe do të rrisni kompetencat tuaja profesionale. Plutoni bashkëpunëtor do t'ju ndihmojë të zgjeroni horizontin dhe të pasuroni lidhjet me të tjerët.

Të kuqtë ndalen nga shtyllat në "Selman Stërmasi", kanë vetëm 2 pikë në 4 javë të luajtura

Partizani prek fundin, barazim me Lushnjën

Skuadra e Iulianos nuk ka shënuar ende një gol

Jeton Selimi

Partizani zhgënjën sërish. Kësaj radhe ndaj Lushnjës, skuadër me të cilën ndan vendin e fundit në Kategorinë Superiore. Të kuqtë e drejtuar nga Mark Iuliano vuajnë shumë të finalizojnë aksionet, një sindromë kjo që e ka mbërthyer Partizanin që nga fillimi i kampionatit, pasi kryeqytetasit ende nuk e kanë gjetur rrugën e rrjetës pas 360 minutave lojë. Padyshim starti më i keq në historinë e klubit të kuq, çka nuk justifikon aspak pritshmëritë e tifozëve dhe të presidencës, që edhe këtë verë nuk u kursyen në shpenzime, duke afruar një staf tërësisht italian. Partizani nuk fiton as ndaj Lushnjës dhe kjo nuk mund të justifikohet as me shtyllën e Sukaajt e as me traversën e Atandës në fund të takimit, ndërsa verdheshilët nuk u vodhën asgjë të kuqe dhe kthehen në shtëpi me një rezultat mëse të merituar, duke vijuar të lënë pas krahëve pikërisht Partizanin. Presidenti Demiri largua nga stadiumi sapa u mbyll pjesa e parë, ndërsa në dhomat e zhveshjes tonet e Luçiano Moxhit ishin të larta. Në fund fjalët e zakonshme, justifikimet për fitoren e mosarritur, por realiteti është se Partizani nga pretendenti për titull kampion, tashmë duhet ta shohë më me seriozitet çështjen e mbijetesës. Mund të duket e ekzagjeruar, pasi janë luajtur vetëm 4 javë kampionat, por shifrat janë kokëforta dhe Skënderbeu, atje në majë të tabelës, ka nisur fluturimin!

KRONIKA

Një fillim sezoni pa ngjyra për ekipin e Mark Iulianos, që dhe me Lushnjën vonoi shumë të dilte në lojën e tij, duke falur pothuajse një pjesë lojë, pasi në 45 minutat e para bëri vullm, por pak raste, si ato të Bardhit në të 16'-tën, Prognit në të 18'-tën, goditja e Bathës pak sekonda më pas, apo një harkim bosh i Trashit në të 24'-ën. Në pjesën e dytë kur Partizani më në fund filloi të luante kishte kundër edhe fatin. Në të 56'-tën Sukaaj që zëvendësoi Xhikhuan, gjeti vetëm murin në goditjen e tij, ndërsa pak sekonda më pas, Batha e Progni provuan radhazi, por Ruco mbi vijën fatale e më pas trupit Gavës mohuan golin. Në të 60'-tën, Adorianit i mungoi shënjestra, ndërsa në të 69'-tën nuk goditi saktë as Kotobelli. Në të 84'-trën, Sukaaj provoi të gjente Vilën, ndërsa pak sekonda më pas Progni pretendoi për penallti, por që nuk u akordua nga kryesori. Përsëritja tregon qartë nëse ishte apo jo.



Partizani nga pretendenti për titull kampion, tashmë duhet ta shohë më me seriozitet çështjen e mbijetesës. Mund të duket e ekzagjeruar, pasi janë luajtur vetëm 4 javë kampionat, por shifrat janë kokëforta

SUPERLIGA

JAVA E 4-t

Të shtunën

Flamurtari-Luftëtari 0-0

Laçi - Vllaznia 2-0

Të dielën

Kamza-Teuta 1-1

Të hënën

Kukësi-Skënderbeu 1-2

Partizani-Lushnja 0-0

TRAJNERI I PARTIZANIT

Iuliano: Dominuam, por fatkeqësisht nuk shënuam

Partizani nuk arriti as në javën e 4-t të merite fitoren në kampionat, madje as t'i gëzohej golit të parë për këtë sezon në Superligë. Të kuqtë barazuan 0-0 ndaj Lushnjës në "Selman Stërmasi", ndërsa trajneri Iuliano, pas takimit u shpreh: "E dominuam kundërshtarin. Nuk arritëm të shënonim as sot për fat të keq. Lojtarët bënë maksimumin në fushë, por ai që na mungoi ishte vetëm goli. Unë si trajner bëra maksimumin për ta drejtuar ekipin drejt fitores. E

thashë, skuadra bëri maksimumin sot, por nuk patëm fat. S'më përgjigjet skuadra? Unë nuk e shoh në asnjë vend që skuadra nuk më përgjigjet në fushë. Në kishim edhe sot shumë raste për gol, ndaj s'mund ta them këtë gjë. Rreziku për të më shkarkuar? Kur një skuadër nuk arrin rezultat, atëherë trajneri është i rrezikuar. Kjo dihet, por u takon drejtuesve të vendosin për këtë gjë. Nëse drejtuesit e marrin vendimin për të më larguar, atëherë e mendojnë për të mirën e skuadrës. Por unë ndjej mbështetjen e klubi



bit dhe punoj në kushte të mira. Çani? Nuk duam të rrezikojmë me aktivizimin e tij. Donim ta kishim sot në fushë, sepse është një lojtar shumë i mirë. Nuk e di saktë se kur do të kthehet, sepse po ndjek një program të veçantë për rikuperimin", tha trajneri i Partizanit, Mark Iuliano për "Supersport".

TRAJNERI I LUSHNJËS

Bano: E merituar pikën që morëm ndaj Partizanit

Pas barazimit 0-0 kundër Partizanit, trajneri i Lushnjës, Artan Bano u shpreh: "Mendoj se skuadra po përmirësohet dita-ditës dhe këtë e treguam edhe ndaj Partizanit. E kishim studiuar kundërshtarin. Partizani bën një futboll mekanik, me pasime vertikale nga Trashit. Edhe me pak fat, e pranoj, arritëm ta ndalnim kundërshtarin. Unë kam një skuadër ku pjesa më e madhe e lojtarëve kanë luajtur në Kategorinë e Parë. Futbollistëve të mi u nevojitet pak edhe lavazh truri dhe ky barazim sot do t'iu shërbejë për të kuptuar se mund të marrim rezultate ndaj çdo kundërshtari. Na vlen për moral ky barazim, pasi këta futbollistë kanë kualitet, cilësi, harmoni jashtë fushë. Unë kam besim të kjo skuadër. Ne do bëjmë maksimumin për të qëndruar në Superligë. Cilido ekip që del shpejt nga kategoria, nuk i bën mirë garës, ndaj them që ne do rezistojmë. Fusha? Nuk mund të investojë bashkia brenda vitit një miliard lekë. Ky është një problem i mbartur", tha trajneri i Lushnjës, Artan Bano për "Supersport".



Trajneri i Kombëtares ka dalë dje në konferencë për shtyp

Panuçi: Spanja ka mungesa? Të kisha edhe unë hallet? Të Lopeteguit...

Trajneri i Kombëtares shqiptare, Kristian Panuçi ka dalë ditën e djeshme në një konferencë për shtyp në prag të sfidës ndaj Spanjës dhe Italisë. Italiani ka folur për rëndësinë që këto dy ndeshje kanë për imazhin e Shqipërisë dhe ka treguar se në fushën e lojës do jenë 11 luanë!

Rikthimi i Xhakës dhe Cikalleshit

"Për Cikalleshin dhe Xhakën nuk e kam thënë asnjëherë që nuk do të rikthehen në Kombëtare. Xhaka ka kërkuar ndjesë disa herë. Ka kuptuar se çfarë ka ndodhur dhe tashmë do të rikthehet në

grup. Cikalleshi nuk respektoi oraret, qëndroi në shtëpi dhe ai tashmë është pjesë e grupit. Ata janë dy futbollistë shumë të mirë dhe kërkoj që të na japin një dorë më shumë në ecurinë tonë".

Sfida me Spanjën dhe Italinë

"Spanja dhe Italia janë dy ndeshje shumë më të forta se ne, por futbollin na mëson se mund të bëjmë gjëra të rëndësishme edhe kur ke kundërshtarë të fortë. Këto janë ndeshje kur interesi dhe përqendrimi është shumë i madh. Duhet të bëjmë dy ndeshje plotë krengari dhe dëshirë".

Asnjë lojtar nga Superliga

"Po i shoh të gjithë, por në këto dy ndeshje historike kam vendosur që të mbaj grupin e zakonshëm. Lilaj? Jam duke e ndjekur, por për momentin siç e thash më lart, vendosa që të marr grupin".

Mungesat e Italia dhe Spanja

"Edhe pse kanë mungesa, Lopetegui mund të fletë më shumë se unë. Spanja i ka futbollistët për t'i zëvendësuar. Do të nis të mendoj më shumë për Italinë, por nga e shtuna. I referohem një fraze të Simeones, që duhet të dimë defektet tona. Duhet të kemi respekt për Spanjën dhe Italinë. Ndaj Spanjës të luash mirë është shumë e




vështirë, sepse ata gjithmonë kanë 70% të zotërimin të topit. Duhet të luajmë me kurajë. Preferoj që të humbas, por duke luajtur me kurajë. Spanja është e fortë, por mund të ndodhë gjithçka. Jam tmerrësisht i sëmure për suksesin e Kombëtares, edhe pse pjesa që mbetet u përket lojtarëve. Kukeli, Mavraj dhe Roshi

janë mungesa të rëndësishme, por do të mundohem që të hedh në fushë 11-shen më të mirë".

Skualifikimi i mundshëm i Spanjës

"Nuk dua të përfshihem në situata politike, pasi nuk më pëlqen. Ne do të shkojmë që të bëjmë ndeshjen tonë, për pjesën tjetër nuk mendoj aspak".

Fjalëkryqi (1)



- 42. Dikur quhej Mediolanum.
- 43. Ruajné pa ujë.
- 44. Një mund të jetë kalendrik.
- 46. Një është meskini, shpirtngushti.
- 47. Një hidrokarbur.
- 48. Mund të jetë franceskan.

VERTIKAL

- 1. Jessica Parker aktore.
- 2. Zola shkrimtar.
- 3. Janë dritë të tilla me parsec.
- 4. Mund të jenë gjaku.
- 5. United Kingdom.
- 6. Eshtë njëri me principe.
- 7. Një polimer për kirurgji estetike.
- 8. Kufizojné takimet.
- 9. Diftong teatral.
- 10. Fillojnë fluturimin.

HORIZONTAL

- 1. Një pije freskuese.
- 7. Graf ish teniste.
- 12. Dada, ish-diktator i Ugandës.
- 13. Eshtë pasuri e investuar.
- 15. Mund të jenë fetare.
- 16. Një pjesë e retacionit.
- 17. Fillojnë ambalazhimin.
- 19. Një vegël.
- 20. Qe harkëtar i famshëm i akejeve.
- 24. Fillojnë hetimin.
- 25. Një atentator vëtvrasës.
- 26. Kështu janë takimet zyrtare.
- 29. Eshtë anije me dy skafe.
- 31. Fundi i Turandot.
- 32. Inicialet e Reitman regjisor.
- 33. Farrell regjisor.
- 34. Schneider që qe aktore.
- 36. Mund të jetë e lirë për hartim.
- 38. Emri i Pasternak.
- 39. Ekberg e La dolce vita.

- 11. Makina Uno.
- 14. Eshtë shpend lagune.
- 18. Eshtë operator që bën zoom.
- 20. Eshtë i pashpirt.
- 21. Parashtesë për një.
- 22. Pak enigmatike.
- 23. Një pjesë e Toskërisë.
- 25. Agustini ish-bomber.
- 26. Kufizojné njënj princip.
- 27. Miku i Batman.
- 28. Tapeti për judo.
- 29. Janë stadet në videogame.
- 30. Bëhet një kundër vendimit.
- 34. Janë me blerim mbuluar në një film
- 35. Eshtë shtet aziatik.
- 37. Papavrami violinist
- 38. Fadili komik
- 40. Përhëndetja e Jul Qezarit.
- 41. Mbyllin fushatat.
- 42. Me të bëjnë një ketër.
- 45. Mbyllin një takimin.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- 1. Një pemë gjigante.
- 6. Janë për të kërcyer.
- 13. Ishite shkolla e Aristotelit
- 15. Një thirrje me emra.
- 17. Gjysmë rivale.
- 18. Një pjesë e narkotikëve.
- 19. Një tis... mjegulle
- 20. E famshme ajo e Keopsit
- 23. Mbyllin një sirtar
- 24. Eshtë ngjyrë e... fytyrës.
- 25. Fillojnë lejen.
- 26. Janë aktorë kryesorë.
- 29. Janë kompozime të kënduara.
- 30. Hudson aktore.
- 31. Satelit i Uranit.
- 32. Fillojnë tatëpjepën.
- 33. Mbetur në fund.
- 34. Sapo fillojnë.
- 35. Kastile janë në fund.
- 36. Kufij takimi.


VERTIKAL

- 1. Mund të jetë sekrete në derë.
- 2. Makina Agila.
- 3. Ami i Maupassant.
- 4. Mbyllin një sirtar.
- 5. Rrëzohen me strike
- 6. Luciano tenor i paharruar.
- 7. Mbyllin këndet
- 8. Eshtë borxh.
- 9. Mbyllin portat.
- 10. Hagen rockstar.


- 11. Një pjesë e akademisë.
- 12. Bien me ballë.
- 14. Një barkë lëkurëkuqsh.
- 16. Aje ku shkon progresisti
- 20. Pallati i Dalai Lamas në Lhasa
- 21. Një pjesë e minoritetit.
- 22. Eshtë fluturues në ufo.
- 24. Do të bëhen mace të tilla.
- 25. Fletë pa kufij.
- 27. I ka tek rendi.
- 28. Kreshniku i volejbolit.
- 29. Një det që është liqen në fakt.
- 36. As unë, as ai.
- 37. Në mes të King edhe Cole të muzikës.
- 39. Një parashtesë zmadhuese.
- 40. Eshtë llon papagalli.
- 41. Titulli i Sean Connery.
- 42. Fillojnë panikun.
- 43. Gjysma e rojave.
- 44. Fitim pa kufij.
- 46. Mbyllin një sherr.
- 47. Fillojnë një metodë.
- 48. Kufizojné botimet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		2	9			8		3
9	5	4					1	
			2	1				7
	9			6	3		7	8
5			4		8			1
4	3		7	9				2
7				3	9			
	1					7	6	5
8		6			5	2		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	9	7	8	2	6	5	4	3
3	8	4	5	1	9	7	2	6
6	2	5	4	3	7	1	8	9
2	3	1	7	6	8	4	9	5
7	4	6	2	9	5	8	3	1
9	5	8	3	4	1	2	6	7
5	6	9	1	8	2	3	7	4
4	1	2	9	7	3	6	5	8
8	7	3	6	5	4	9	1	2

Argëtim filozofik

-Kujdesi shpie në përjetshmëri , moskujdesi në vdekje ; të kujdesshmit nuk vdesin kurrë , të pakujdesshmit janë si të vdekur .

- Thellohuni vetëm të njëra . Cila? Te dhembshuria e madhe , Kushdo që ka shumë dhembshuri , ka të gjitha cilësitë e Budës në pëllëmbën

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	1	11	16		7	5	15	8		3	8	S	T	A	R	E	T	I	K	E	T	A	T		
1	Z	8	13	8	6		6	8		4	3	8	12	A	R	M	I	K		S	T	O	L	I	T	E
2	I	7		10	8	9	2		15	2	11	3	2	L	I	O		R	O		M	I	N	A	T	
9	L	14	8	12	17	12	3	7	9	9	2			L	O		C	A	B	A	R	E	T	L	A	
4	8	6	5	2	15	8		7	15		10	7		A	B	A	T	E	R	I	T	E	A	R		
7	5	7	12	7	15		6	11	6	8	15			T	R	I	M	E	R	I	T	E	A	N	E	
5	6	4	7		5	2	18	2		11	19	7		A	R	T	U	R	O	U	I	M	A	T	T	
5	4	11	6	19			9	8		4	8	6		A	R	S	E	N		E	A	A	A			
9	11	15			1	7	5	8		19	8	1	8	A	D	A	T		M	E	T	R	I	C		
7	6	2	14		14	7		16	11	15	7			P	A	K	T		P	I	R	A	T	E	R	I
5	7	8	4		8	9	3	8	15	7	5			L	E	C	E	P	I		N	A	T	A		

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FERMANI T J NA
AKSI L OVALE
RO NE P FRENATA
A H I P O K R I T E T D
D E M O S T E N I I K E
D I K A S T E R E T N O R
A M A L I A I Z E N E A
D E L E R A E P I T E T
I G O M A I D M A D H I
S R I R I E L I R E N
T E R R O R I A R E N A T

FJALËKRYQI (2)

L U I S S P A M A L I A
A L K T R O B E R I A
P F I N A L J A A K R N A
R E P A R T E T N S I A
T E R E K S I P N I
P A R E T T R U K E T U
A R I T R E A L K U P A
S F I T I M E T
T A N D E M N E R U R U
A H O T E L E T T R A U
J U K A T E R



Thënie të mençura

- Nuk kërkoj kompensim rilindjen në Qiell, por kërkoj të mirën e njerëzve, kërkoj të ridrejtoj ata që kanë humbur dritën e tyre, ata që jetojnë në errësirë dhe të zhduk nga bota të gjitha dhimbjet e vuajtjet.
- Papjekuria është paafësisë që dikush të përdorë inteligjencën e vet pa u pirë nga të tjerët.
- Immanuel Kant Filozof (1724-1804)
- Disa njerëz japin premtime për hir të kënaqësisë që kanë kur nuk i mbajnë ato. (Hezlit)

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

